KRONIKË E NJË VDEKJEJE TË PARALAJMËRUAR

G.G. Markez

GABRIEL GARSIA MARKEZ

"Në gjahun e dashurisë vritet lart."
ZHIL VISENTE[1]

Ditën që do ta vrisnin, Santiago Nasari u ngrit më 5.30 të mëngjesit për të pritur anijen me të cilën vinte ipeshkvi. Kishte parë ëndërr sikur ecte nëpër një pyllishte me fiq të mëdhenj, ku vesonte një shi i imët e i butë dhe për një çast, në ëndërr, qe lumturuar, por kur u zgjua e ndjeu veten si të stërpikur me glasa zogjsh. "Ngaherë shihte në ëndërr pemë", më tha Plasida Lineroja, e ëma, duke sjellë ndër mend pas 27 vjetësh hollësitë e asaj të hëne të zezë. "Para një jave kishte parë në ëndërr sikur ëndërronte fill i vetëm në një aeroplan prej varaku që çante pa u përplasur midis pemësh bajameje", shtoi. E mbanin ustalleshë për të shpjeguar ëndrrat e tjerëve, kur ato i tregoheshin esëll, porse nuk pat vënë re asnjë ogur të lig në dy ëndrrat e të birit, as në ëndrrat e tjera me pemë që ai i kishte rrëfyer mëngjeseve disa ditë para vdekjes.

As vetë Santiago Nasari nuk kishte parandier gjë. Kishte fjetur keq dhe pak, pa i hequr rrobat, dhe qe zgjuar me një dhembje koke e me

[1] *Zhil Visente (rreth 1470-rreth 1536) – poet satiric dhe dramaturg i shquar portugez*

një shije prej llurbe minerale në qiellzë, të cilat i shpjegoi si pasoja të natyrshme të zdërhalljes së dasmës që kishte vazhduar deri pasmesnate. Njerëzit e shumtë që kishte takuar kur doli prej shtëpisë më 6.05 të mëngjesit deri kur u shkua në thikë si thi një orë më vonë, e mbanin mend pakëz të përgjumur, por çakërrqejf, dhe të gjithëve u pat thënë në muhabet e sipër se qe një ditë shumë e bukur. Askush nuk qe i sigurt nëse e kishte pasur fjalën për motin. Kujtimet e një pjese puqeshin në faktin se kishte qenë një mëngjes rrëzëllitës me një puhizë deti që frynte përmes bananishteve, siç duhej të kishte qenë një mot i zymtë me një qiell të turbullt e të ulët, me një kutërbim ujërash të amullt dhe se në çastin e mynxyrës po binte një shi i hollë si ai që kishte parë Santiago Nasari në pyllishten e ëndrrës. Unë po këndellesha nga orgjia e dasmës në prehrin apostolik të Maria Alehandrina Servantesit dhe mezi u zgjova nga potera e kambanave që binin për berihaj, mbasi mendova se binin për nder të ipeshkvit.

Santiago Nasari kishte veshur një palë pantallona dhe një këmishë prej linoje të bardhë, të dyja të pakollarisura, njësoj si ato që kishte veshur një ditë më pare në dasmë. Ishin rrobat e tij më të mira. Po të mos kishte qenë ardhja e ipeshkvit, do të kishte veshur kostumin kaki dhe do të kishte mbathur çizmet me të cilat i hipte kalit kur shkonte të hënave në *hasiendën*[2] e tij "Divino Rostro", që e kishte trashëguar nga i ati dhe që e qeveriste me shumë mend e qokë, ndonëse s'para i vinte mbroth. Për në mal mbante në brez një "Magnum 57", plumbat e të cilit, siç thoshte, mund të ndanin një kalë më dysh. Në kohën e gjahut të thëllëzës merrte edhe pajimet për gjueti me fajkua. Veç kësaj, në dollap kishte edhe një pushkë "Maliher-shonauer 30,06", një 300-she

[2] *Në Amerikën Latine, pronë e vogël jashtë fshatit, zakonisht me gjë të gjallë.*

"Holland Magnum", një 22-she "Hornet" me dylbi me zmadhim dyfish dhe një "Uinçester" vetëmbushës. Gjithmonë flinte siç pat fjetur i ati, me armën të fshehur brenda këllëfit të jastëkut, dhe atë ditë, para se të dilte nga shtëpia, ia kishte nxjerrë fishekët dhe e kishte futur në sirtarin e komodinës. "Asnjëherë nuk e linte të mbushur", më tha e ëma. Unë këtë e dija, dija edhe që i ruante armët në një vend dhe e fshihte municionin në një vend tjetër shumë larg, në mënyrë që askush të mos binte në ngasje, qoftë edhe rastësisht, për t'i mbushur brenda shtëpisë. Qe një zakon i urtë, që ia kish futur në gjak i ati qysh një mëngjesi kur një shërbëtore shkundi jastëkun për t'i hequr këllëfin dhe pisqolla u shkreh me t'u përplasur pas truallit, ndërsa plumbi shpoi dollapin e kthinës, përshkoi murin e sallonit, kaloi me një fishkëllimë ngjethëse nëpër dhomën e bukës të shtëpisë fqinje dhe bëri copë e thërrime një trupore shenjti në bojë të njeriut në iterin kryesor të kishës, në skajin tjetër të sheshit. Santiago Nasarit, që asokohe qe i vogël fare, ky pësim iu bë mësim për gjithë jetën.

Shëmbëllesa e fundit që i kishte mbetur së ëmës prej të birit ishte kalimi i tij si hije nëpër dhomën e saj të gjumit. Ia kishte prishur gjumin teksa përpiqej të gjente verbazi një aspirinë në raftin e ilaçeve që ndodhej në banjë. Ajo kishte ndezur dritën dhe e kishte parë t'i përhihej te dera me gotën e ujit në dorë, siç kishte për ta kujtuar gjithmonë. Santiago Nasari i kishte rrëfyer atëherë ëndrrën që kishte parë, por ajo nuk u pat dhënë rëndësi pemëve.

- Të gjitha ëndrrat me zogj dalin rnirë, - tha.

E kishte parë nga i njëjti hamak dhe prej të njëjtit pozicion, në të cilin e gjeta, të rrëgjosur nga pleqëria, kur u ktheva në atë fshat të humbur duke u përpjekur të rindërtoja prej aq ciflash të hallakatura pasqyrën e thyer të kujtimit. Edhe në mes të ditës mezi i dallonte trajtat e njerëzve dhe në tëmbla kishte gjethe bimësh mjekësore për dhembjen

e përhershme të kokës, që i pat lënë i biri në atë takim të fundit kur kishte kaluar nëpër dhomën saj të gjumit. Qe shtrirë më brinjë, e ngërthyer pas litarit të kryes së hamakut, duke u përpjekur të ngrihej, ndërsa në të mugëtit e dhomës vinte një erë si ajo e ajrit të amullt të pagëzimtores, që më kishte çuditur aq shumë mëngjesin e krimit.

Sa u dhashë te pragu i derës, asaj iu përngjava si Santiago Nasari. "Aty qe, - më tha.

- Kishte veshur kostumin e bardhë prej linoje, të larë, por të pakollarisur, se e kishte lëkurën aq të butë sa nuk e duronte dot niseshtenë."

Ndenji për një copë herë të madhe në hamak, duke mbllaçitur farëra nasturci, derisa ndjesia që i biri i qe kthyer, i kaloi. Atëherë psherëtiu: "Vetëm atë kisha."

E pashë ashtu siç e kujtonte ajo. I kishte mbushur të 21-rat javën e fundit të janarit dhe qe trupmbledhur e i zbehtë, me qepalla arabi e flokë kokorith si të të atit. Ishte biri i vetërn i një martese, të bërë për llogari, të dy bashkëshortëve që s'patën pasur asnjë çast lumturie. Por ai vetë dukej i lumtur me të atin, derisa ky i vdiq papritmas para tre vjetësh, dhe vazhdoi të ngjante i lumtur edhe me të ëmën fillikate, gjer asaj dite të hëne që vdiq. Prej së ëmës trashëgoi parandjenjat. Prej të atit mësoi qysh i vogël përdorimin e armëve të zjarrit, dashurinë për kuajt dhe zbutjen e shpendëve të egër, por mësoi prej tij edhe artin e të qenit trim e i matur. Flisnin arabisht me njëri-tjetrin, por jo përpara Plasida Lineros, që ajo të mos e ndiente veten të mënjanuar. Kurrë nuk i panë të armatosur në fshat, dhe fajkonjtë e tyre të stërvitur i nxorën vetëm një herë, për të treguar mjeshtërinë e gjahut në një panair bamirësie. Vdekja e të atit e kishte detyruar të linte studimet në vitin e fundit të shkollës së

mesme, për të marrë mbi supe barrën e shtëpisë. Sa për cilësitë, Santiago Nasari qe njeri gazmor, paqtor e zemërdëlirë.

Ditën që do ta vrisnin, e ëma, kur e pa të veshur në të bardha, pandehu se mos kishte ngatërruar datën. "Ia kujtova se ishte e hënë", më tha. Por ai e sqaroi që i pat veshur rrobat e mira se mos ndoshta e sillte puna t'i puthte unazën ipeshkvit. Ajo s'pat treguar pikë interesi.

- As që do të marrë mundimin të zbresë nga anija, - i tha ajo. Do të lëshojë një bekim sa për të thënë, siç bën ngaherë, dhe do ta këpusë qafën. S'e sheh dot me sy këtë fshat.

Santiago Nasari e dinte që kjo qe e vërtetë, por salltanetet e kremteve kishtare e tërhiqnin tej mase. "Më duket vetja si në kinema", më kishte thënë njëherë.

Ndërsa e ëma, me rastin e ardhjes së ipeshkvit, kishte vetëm një merak: që të birin të mos e zinte shiu, mbasi e kishte dëgjuar të teshtinte në gjumë. I tha të merrte një çadër, por ai ia bëri me dorë dhe doli nga dhoma. Ishte hera e fundit që e pa.

Viktoria Gusmani, gjellëbërësja, ishte e sigurt që nuk kishte rënë shi as atë ditë, as gjatë gjithë muajit shkurt. "Përkundrazi, - më tha kur shkova ta takoja pak kohë para se të vdiste.

- Dielli pat zënë të ngrohte më herët se në gusht." Kishte qenë duke pastruar për drekë tre lepuj të therur, e qarkuar nga qentë që dihatnin prej padurimit, kur Santiago Nasari hyri në kuzhinë. "Ngaherë ngrihej mahmur", sillte ndër mend Viktoria Gusmani, pa e fshehur urrejtjen. E bija, Divina Flori, që sapo kish filluar të lulëzonte[3], i kishte prurë Santiago Nasarit një filxhan të madh kafe sade me rum, siç ia bënte çdo të hënë për ta ndihmuar të përballte peshën e natës së shkuar. Në kuzhinën e madhe, me fëshfërimën e lehtë të zjarrit në oxhak dhe

[3] *Lojë fjalësh: Divina Flor – në spanjisht ka kuptimin: Lule Hyjnore*.

me pulat e përgjumura nëpër trarë, seç kishte diçka të mistershme. Santiago Nasari përtypi edhe një aspirinë dhe u ul të pinte me gërrqe të ngadalta kafenë, duke u menduar më nge, pa ua shqitur sytë dy grave që po u nxirrnin lepujve të brendshmet te furra. Me gjithë moshën, Viktoria Gusmani mbahej për mrekulli. Çupa, ende pakëz e egër, dukej sikur mend po mbetej pa frymë nga gufimi i vrullshëm i trupit. Kur vajti t'i merrte filxhanin e zbrazët, Santiago Nasari e mbërtheu nga kyçi i dorës.

- Të ka ardhur koha të shalohesh, - i tha.

Viktoria Gusmani i tregoi thikën e gjakosur.

- Hiqi duart, burravec, - e urdhëroi me të rreptë. - Sa të jem gjallë unë, ti s'pi prej atij burimi.

Ibrahim Nasari e kishte ngashënjyer kur pat qenë ende çupëlinë. Për disa vjet kishte bërë dashuri me të në ahuret e *hasiendës* dhe, kur dashuria i qe fikur, e pat marrë të shërbente në shtëpi. Divina Flori, të cilën ajo e kishte me një burrë më të vonë, e dinte se një natë do të përfundonte medoemos në shtratin e Santiago Nasarit dhe kur mendonte këtë një ankth i parakohshëm e pushtonte. "S'ka bërë më nëna burrë si ai", më tha, trashaluqe dhe e fishkur, e rrethuar fëmijësh të bërë me dashnorë të ndryshëm. "Njësoj si i ati qe, - ia priti Viktoria Gusmani. Një mut si ai". Por nuk kishte mundur ta fshihte të ngjethurit tek kujtonte tmerrin e Santiago Nasarit kur ajo i kishte shkulur të brendshmet një lepuri dhe ua kish hedhur qenve të ngrohta e gjithë avull.

- Mos u bëj shpirtkazmë, - i kishte thënë ai. - Mendo sikur të ishte njeri. Viktoria Gusmanit iu deshën gati 20 vjet për ta kuptuar se si një burrë i mësuar të vriste shtazët e pambrojtura, t'u tronditkësh aq papritmas. "O zot i madh, - klithi e frikësuar, - të ketë qenë vallë një

shenjë paralajmëruese!" Sidoqoftë, aq inate i qenë grumbulluar përbrenda gjellëbërëses atë mëngjes të krimit, saqë kishte vazhduar t'u hidhte qenve të brendshmet e lepujve të tjerë, vetëm e vetëm për t'ia nxjerrë mëngjesin për hundësh Santiago Nasarit. Në këtë kohë e sipër mbarë fshati u zgjua nga uturima e avullores me të cilën vinte ipeshkvi.

Shtëpia, që dikur pat qenë maraze, ishte dykatëshe, me mure prej dërrasash të palatuara dhe me një çati dyujëse prej zinku, mbi të cilën zhgabat përgjonin mbeturinat e portit. Qe ndërtuar në kohën kur lumi punonte me detin dhe shumë anije të vogla, madje edhe të mëdha, kuturiseshin deri në fshat nëpërmes moçalishteve të grykajës. Kur mbaruan luftërat civile dhe erdhi këtu Ibrahim Nasari me arabët e fundit, anijet e detit nuk vinin më, se lumi kishte ndryshuar rrjedhë, kështu që magazja pat dalë jashtë përdorimit. Ibrahim Nasari e kishte blerë për hiçgjë, për të hapur në të një dyqan mallrash importi, të cilin nuk e hapi asnjëherë, dhe vetëm kur po martohej e ktheu në shtëpi banimi. Në katin përdhes bëri një sallon që të shërbente për gjithçka dhe në fund të shtëpisë ndërtoi një stallë për katër kuaj, kthinat për shërbëtorët dhe një kuzhinë të madhe me dy dritare që binin nga porti, prej të cilave hyme orë e çast kutëribimi i ujërave të amullt. Gjëja e vetme që la të paprekur në sallon ishte shkalla spirale e mbetur nga ndonjë anije e mbytur. Në katin e sipërm, ku më parë patën qenë zyrat e doganës, sajoi dy dhoma gjumi të mëdha dhe pesë kthina për kalamajtë e shumtë që kish ndër mend të bënte. Ndërtoi gjithashtu një ballkon prej druri që binte mbi bajamet e sheshit, në të cilin Plasida Lineroja ulej mbrëmjeve të marsit për të ngushëlluar vetminë e vet. Nga përpara e ruajti portën kryesore dhe i bëri dy dritare të larta me drunj të gdhendur. E ruajti edhe derën e pasme, vetëm se ia ngriti pakëz qemerin sa për të kaluar edhe me kalë, dhe mbajti në përdorim një pjesë të skelës së vjetër. Dera e pasme qe ajo që përdorej më tepër, jo vetëm sepse

nëpërmjet saj hyhej drejt në grazhd e në kuzhinë, por sepse nxirrte te porti i ri pa kaluar nëpër shesh. Porta e përparme, përveçse në raste festash, qëndronte e mbyllur dhe me lloz të hedhur. Megjithëkëtë, pikërisht para kësaj dhe jo para derës së prapme e prisnin Santiago Nasarin ata që do ta vrisnin, dhe pikërisht prej andej doli ai për të pritur ipeshkvin, ndonëse duhej t'i binte rreth e përqark shtëpisë për të dalë në port.

Se si u puqën këto rastësi ogurzeza askush nuk e mori vesh. Hetuesi që erdhi nga Rioaça, ndonëse duhej të kishre nuhatur diçka, qe përpjekur t'u bënte bisht dhe në procesverbal dukej qartë orvatja e tij për t'i dhënë çështjes një shpjegim të arsyeshëm. Porta e sheshit përmendej shpesh me një emër si nëpër romanet e verdha: "Porta fatale". Në të vërtetë, i vetmi shpjegim i vlefshëm duhej të ishte ai i Plasida Lineros, e cila i qe përgjigjur pyetjes me gjykimin e saj prej nëne: "Im bir nuk dilte kurrë nga dera e pasme kur kishte veshur rrobat e mira." Po aq i thjeshtë qe ky gjykim, saqë hetuesi e kishte shënuar përanash faqes, pa e hedhur në procesverbal.

Viktoria Gusmani, nga ana e saj, qe e prerë në përgjigjen se as ajo e as e bija, nuk dinin gjë që Santiago Nasarin po e prisnin për ta vrarë. Por, me kalimin e viteve, pranoi se që të dyja e dinin kur ai hyri në kuzhinë për të pirë kafenë. Ua kish thënë një lypsare që kish kaluar para orës pesë për të kërkuar pak qumësht. Ajo u pat treguar edhe shkaqet dhe vendin ku po e prisnin. "Nuk e paralajmërova, mbasi kujtova se qenë dëngla pijanecësh", më tha Viktoria Guzmani. Sidoqoftë, Divina Flori, në një vizitë të fundit që i bëra pas vdekjes të së ëmës, më kallëzoi se kjo nuk i pat thënë asgjë Santiago Nasarit ngaqë së thelli shpirtit deshte që ta vrisnin. Ndërsa ajo vetë nuk e kishte paralajmëruar, sepse asokohe s'kish qenë veçse një çupëlinë frikacake,

që s'bënte dot asgjë me kokë të vet. Veç kësaj, qe frikësuar edhe më tepër kur ai e kishte mbërthyer për kyçi me një dorë që asaj i qe dukur e ngrirë dhe e gurtë, si prej të vdekuri.

Nëpër mugëtirën e mëngjesit Santiago Nasari kishte përshkuar me hapa të mëdhenj shtëpinë, i ndjekur nga uturima e hareshme e anijes së ipeshkvit. Divina Flori rendi përpara t'i hapte portën, duke u përpjekur t'i shmangej nëpër sallon, midis kafazeve me zogj që flinin, orendive prej xunkthi dhe poçeve me fier të varura, por, kur i hoqi llozin portës, nuk u shpëtoi dot kthetrave të gjerakut mizor: "Ma nduku sa desh ma shkuli vendit, më tha Divina Flori. - Kështu bënte gjithmonë kur më gjente vetëm në ndonjë qosh të shtëpisë. Veçse asaj dite nuk më erdhi frikë si zakonisht, por më erdhi tmerrësisht për të qarë." U hoq mënjanë që t'i lëshonte udhë dhe, përmes portës gjysmë të hapur, i zuri syri bajamet e sheshit të mbuluara me borën vezulluese të ditës që po zbardhte dhe nuk pati zemër të shihte gjë tjetër. "Atë çast pushoi uturima e anijes dhe filluan të këndojnë gjelat, - më tha. - Qe një zhurmë aq e madhe, sa të dukej e pabesueshme që në fshat të paskësh aq shumë gjela dhe unë pandeha se mos vinin me anijen e ipeshkvit." E vetmja gjë që mundi të bënte ajo për burrin të cilit nuk do t'i përkiste kurrë ishte që, në kundërshtim. me urdhrin e Plasida Lineros, të mos ia shkonte llozin portës, në mënyrë që ai të mund të kthehej edhe një herë në shtëpi në rast nevoje. Dikush, që nuk u mor vesh asnjëherë se cili qe, kishte futur poshtë portës një letër me zarf, në të cilën paralajmëronte Santiago Nasarin se po e prisnin për ta vrarë, duke i treguar njëkohësisht edhe vendin, shkaqet dhe hollësi të tjera shumë të sakta të planit të fshehtë. Letra ishte përdhe kur Santiago Nasari kishte dalë prej shtëpisë, por ai nuk e pa, nuk e pa as Divina Flori, nuk e pa asnjeri deri shumë kohë pas kryerjes së krimit.

Ishte ora gjashtë e mëngjesit, por fenerët e rrugëve qenë ende të ndezur. Në degët e bajameve dhe në disa ballkone kishin mbetur ende kurora të larushme të dasmës dhe të krijohej përshtypja sikur sapo i kishin varur për nder të ipeshkvit. Mirëpo sheshi i shtruar me plloça deri tek oborri i kishës, ku qe ngritur podiumi për sazexhinjtë, ishte mbushur me pirgje shishesh e grumbuj plehurishtesh pas dëfrimit të natës. Kur Santiago Nasari doli nga shtëpia, mjaft njerëz rendnin me vrap drejt sirenës së anijes.

I vetmi dyqan i hapur në shesh ishte ai i qumështit ngjitur me kishën, ku rrinin ata të dy që prisnin Santiago Nasarin për ta vrarë. Klotilde Armenta, e zonja e dyqanit, ishte e para që e pa Santiago Nasarin nëpër flakërimin e agut dhe iu përngja si të qe veshur me alumin. "Qysh atë çast dukej si fantazmë", më tha. Ata që do ta vrisnin i kishte zënë gjumi nëpër karrige, duke shtrënguar pas vetes thikat e mbështjella me gazeta dhe Klotilde Armenta mbajti frymën për të mos i zgjuar.

Ishin binjakët Pedro dhe Pablo Vikaria. Qenë 24 vjeç dhe ngjanin aq shumë me njëri-tjetrin sa e kishe vështirë t'i dalloje. "Nga të parët s'ta mbushnin syrin, porse qenë burra me plot kuptimin e fjalës", thuhej në procesverbalin e hetimeve. Unë, që i njihja qysh prej shkollës fillore, do të kisha thënë të njëjtën gjë. Atij mëngjesi qenë ende me kostumet e dasmës prej shajaku të zi, mjaft të trasha e të pavolitshme për karaibasit. U ishte prishur çehreja nga gjithë ato orë zdërhalljeje, por ama për t'u rruar qenë rruar. Ndonëse s'kishin pushuar së piri qysh prej fillimit të dasmës, tri ditë të shkuara, nuk ishin dehur, veçse ngjanin si somnambulë që s'mbyllnin dot sy. I pat kapluar gjumi në pikë të agimit, pas pothuajse tri orësh pritjeje në dyqanin e Klotilde Armentës, dhe ky qe gjumi i tyre i parë qysh prej të premtes. U shpërgjumën paksa kur ra

për së pari sirena e anijes, por nuhatja i zgjoi plotësisht kur Santiago Nasari doli prej shtëpisë. Çmbështollën gazetat dhe Pedro Vikarioja bëri të ngrihej.

- Për hir të zotit, - u pështpëriti Klotilde Armenta. - Lëreni për më vonë, së paku për respekt të sendor ipeshkvit.

"Qe dora e zotit", përsëriste ajo më pas. Pat qenë, sigurisht, një rrethanë e ardhur si me porosi, porse medet, me efekt shumë të shkurtër. Kur e dëgjuan, binjakët Vikario u menduan pak dhe ai që qe ngritur u ul përsëri. Të dy e ndoqën me vështrim Santiago Nasarin tek përshkoi. sheshin. "E shikonin më tepër me keqardhje", thoshte Klotilde Armenta. Atë grimë kaloi përmes sheshit edhe një vargan i çrregullt çupash të shkollës së murgeshave me uniformën e jetimores.

Plasida Lineroja kishte pasur të drejtë: ipeshkvi nuk zbriti nga anija. Në port, përveç parisë dhe kalamajve të shkollës, kishte shumë kallaballëk dhe anembanë dalloheshin nëpër kaçile gjelat e kuar paq që i shpiheshin dhuratë ipeshkvit, meqenëse supa me lafsha qe gjella e tij më e pëlqyer. Në skelë ishin mbledhur aq dru e darovi të tjera, saqë anijes do t'i ishin dashur dy orë t'i ngarkonte. Por ajo nuk u ndal. U shfaq te kthesa e lumit, duke shfryrë si një dragua, dhe atëherë banda zuri t'i binte himnit ipeshkvor, ndërsa gjelat nëpër kaçile ia thanë kënggës duke ngritur në këmbë edhe gjelat e tjerë të fshatit.

Asokohe, anijet legjendare me rrotë dhe që ushqeheshin me dru pothuajse qenë zhdukur, edhe ato të pakta që kishin mbetur në lundrim nuk kishin as pianolë, as kamare për muaj mjalti dhe mezi çanin kundër rrymës. Por anija e ipeshkvit ishte e re, kishte jo një po dy oxhakë me një flamur kombëtar si për byzylyk, ndërsa rrota me fletë majë pupës i jepte pamjen e një anijeje të shpejtë detare. Në urën e sipërme, pranë kamares së kapitenit, qëndronte ipeshkvi me veladon të bardhë e me një shpurë spanjollësh.

“Qe një mot si për kërshëndella”, tha ime motër Margoti. Sipas saj, kishte ngjarë kështu: sirena e anijes fërshëlleu dhe nxori një piskajë avulli duke i bërë qull ata që ndodheshin pranë bregut. Kishte qenë një vegim i çastit: përballë turmës së skelës, ipeshkvi ngriti krahun dhe zuri të bënte në ajër shenjën e kryqit, pastaj vazhdoi ta përsëriste rnekanikisht, pa e mendjen derisa anija humbi nga sytë dhe mbeti vetëm potera e gjelave.

Santiago Nasari kishte të drejtë ta ndiente veten të mashtruar. Duke iu përgjigjur thirrjeve publike të at Karmen Amadorit, ai kishte flijuar disa barrë me dru dhe, veç kësaj, kishte zgjedhur edhe gjelat me lafshë më të mira. Por kjo mërzi i kaloi sa hap e mbyll sytë. Sime motre Margotit, që ndodhej pranë tij në skelë, iu duk plotësisht në qejf dhe i gatshëm të vazhdonte ndërhalljen, ndonëse aspirinat nuk e kishin lehtësuar asnjë fije. "Nuk dukej i shqetësuar dhe vriste mendjen vetëm se sa kishte kushtuar dasma", më tha ajo. Kristo Bedoja, që ndodhej me ta, përmendi shifra që të linin pa mend. Kishte dëfryer tok me Santiago Nasarin e me mua pothuaj gjer në katër të mëngjesit, por në vend që të shkonte për të fjetur në shtëpi, kishte mbetur me muhabet në shtëpi të gjyshërve. Aty kishte mbledhur shumë të dhëna që i mungonin për të përllogaritur shpenzimet e dasmës. Llogariti se për mysafirët qenë therur dyzet misërokë dhe njëmbëdhjetë derra, si dhe katër mëshqerra që dhëndri kishte urdhëruar t'i vinin për t'i pjekur për gjindjen drejt e te sheshi. Llogariti se qenë harxhuar 205 arka kontrabandë me pije alkoolike dhe qenë shpërndarë pothuaj 2000 shishe me rum. Nuk mbeti njeri, i kamur a i skarnur qoftë, që të mos kishte marrë pjesë në një mënyrë ose në një tjetër në zdërhalljen më të bujshme që qe parë ndonjëherë në fshat. Santiago Nasari ëndërroi me zë të lartë.

- Kështu do të jetë edhe dasma ime, - tha.

- Një jetë e tërë s'do të mjaftojë për ta rrëfyer.

Time motër e pushtoi një ngazllim i papërshkrueshëm. Solli edhe një herë ndër mend të lumturën Flora Migel, së cilës fati i pat dhënë aq shumë gjëra e që për kërshëndellat e atij viti do t'i jepte edhe Samiago Nasarin për burrë. "E kuptova befas se martesë më e mirë s'kish si bëhej, më tha. - Përfytyro siç ish i bukur, serioz, me një pasuri të vetën qysh në moshën 21-vjeçare." Margoti e ftonte shpesh të hante mëngjesin nga ne kur kishim petulla prej *manioke* dhe ime më atë mëngjes pikërisht petulla po bënte. Santiago Nasari pranoi me gëzim.

- Sa të ndërrohem dhe erdha, - tha ai dhe papritmas iu kujtua se kishte harruar orën e dorës mbi komodinë. - Sa është ora?

Ora ishte 6.25. Santiago Nasari i futi krahun Kristo Bedojës dhe mori për nga sheshi.

- Për një çerek ore më ke aty, - i tha sime motre.

Ajo nguli këmbë që të shkonim menjëherë se mëngjesi ishte gati. "Ngulmoi në një mënyrë të çuditshme, - më tha Kristo Bedoja. - Aq sa nganjëherë them se mos Margoti e dinte që kishin për ta vrarë dhe deshte ta fshihte në shtëpinë tuaj." Megjithëkëtë, Santiago Nasari ia mbushi mendjen të shkonte përpara, ndërsa ai do të vishte kostumin e kalërimit, se i duhej të vente sa më shpejt në hasiendë për të tredhur mëzorët. Me të njëjtën lëvizje të dorës me të cilën qe ndarë me të ëmën, u nda edhe me Margotin dhe u largua për nga sheshi duke tërhequr për krahu Kristo Bedojën. Për time motër qe hera e fundit që e pa.

Shumica e tyreve që ndodheshin në porte dinin që Santiago Nasarin po e prisnin për ta vrarë. Don Lasaro Aponteja, kolonel akademie në pension dhe kryetar bashkie prej njëmbëdhjetë vjetësh, e përshëndeti ushtarakisht me gishta. "Kisha arsyet e mia të forta për të qenë i sigurt se nuk e kërcënonte asnjë rrezik", më tha. Edhe at Karmen Amadori nuk u shqetësua. "Kur e pashë shëndoshë e mirë, mendova se

të gjitha patën qenë thashetheme", më tha. Askush nuk e pyeti veten nëse qe apo s'qe i paralajmëruar Sandago Nasari, sepse u dukej e pamundur që të mos ishte.

Në të vërtetë, ime motër Margoti, qe një nga të paktët që ende nuk e dinin se Santiago Nasarin po e prisnin për ta vrarë. "Po ta kisha ditur, do ta kisha sjellë në shtëpi sikur edhe të lidhur", i deklaroi ajo hetuesit. Çudi ishte që nuk e dinte, por çudi edhe më e madhe ishte që nuk e dinte as ime ëmë, që e merrte vesh çdo gjë para ne të gjithëve, ndonëse kishte vite që nuk dilte në rrugë as edhe për të vajtur në meshë. Unë ia çmoja këtë cilësi qysh kur pata filluar të ngrihesha herët për të vajtur në shkollë. E gjeja siç qe në ato kohë, të zbehtë e të nemitur, duke fshirë oborrin me një fshesë të madhe në dritën e mugët të agimit dhe, teksa pinim kafenë, ajo më rrëfente pas çdo gërqeje se ç'kishte bërë vaki nëpër botë ndërsa ne flinim.

Dukej sikur qe lidhur nëpërmjet fijesh të fshehta me banorët e tjerë të fshatit, sidomos me ata të moshës së saj, dhe nganjëherë na habiste me lajmet e parakohshme, të cilat vetëm po të ishte fallxhore mund t'i merrte vesh. Megjithëkëtë, atë mëngjes nuk e ndjeu flatrimin e tragjedisë që po afrohej qysh më tre ndaj të gdhirë. Kish mbaruar së fshiri oborrin dhe, kur ime motër doli për të pritur ipeshkvin, e kish lënë duke zënë brumët për petullat. "Dëgjoheshin gjelat", thoshte gjithnjë e ëmë tek kujtonte atë ditë. Veçse në mendjen e saj ajo këtë zhurmë e lidhte më tepër me jehonat e fundme të dasmës, sesa me ardhjen e ipeshkvit.

Shtëpia jonë ndodhej larg sheshit të madh, në një pyllishte *mangosh* buzë lumit. Ime motër kishte vajtur në port duke i rënë anës bregut dhe njerëzit qenë aq kureshtarë për vizitën e ipeshkvit, sa s'ia kishin ngenë të merreshin me lajme të tjera. Patën nxjerrë të sëmurët

para shtëpive, që të merrnin bekimin shkrimtar të zotit, dhe gratë dilnin me vrap prej oborreve me misërokë, gica dhe lloj-lloj darovish për të ngrënë, teksa nga bregu kundruall vinin barka të stolisura me lule. Por, sapo që ipeshkvi kaloi pa vënë këmbë në stere, lajmi tjetër zu të përhapej e të bënte bujë. Pikërisht atëherë ime motër Margoti e mori vesh gjithë ç'pat bërë vaki: Anhela Vikarion, bukuroshen që qe martuar një ditë më parë, i shoqi e kishte kthyer në shtëpi, se nuk e kishte gjetur të virgjër. "M'u duk sikur më pat ardhur mua vdekja, - tha ime motër. - Sado që ta ktheja e ta vërtisja hesapin, nuk e shpjegoja dot se si qe futur i gjori Santiago Nasar në këtë mesele." Gjëja e vetme që dihej me siguri ishte që vëllezërit e Anhela Vikarios i kishin zënë pritë për ta vrarë.

Ime motër u kthye në shtëpi duke kafshuar buzët për të mos u shkrehur në vaj. E gjeti time ëmë në dhomën e bukës, me fustmin e mirë me lule të kaltra që c kishte veshur se mos kalonte ipeshkvi për të na përshëndetur, duke kënduar një këngë për dashurinë e fshehtë e duke shtruar tryezën. Ime motër vuri re se qe shtuar edhe një pjatë.

- Për Santiago Nasarin, - i tha ime ëmë.

- Më thanë se e kishte ftuar për të ngrënë me ne.

- Hiqe, - i tha ime motër.

Dhe ia tregoi të gjitha. "M'u duk sikur ajo e dinte, - më tha më vonë. Si ngaherë kur dikush fillon t'i tregojë diçka dhe, pa arritur te gjysma, ajo e di se si mbaron." Por kësaj here lajmi i lig qe një nyje e lidhur pisk edhe për time ëmë. Ajo qe nuna e Santiago Nasarit, të cilit i pat dhënë emrin, por kishte edhe një lidhje gjaku me Pura Vikarion, të ëmën e nuses së kthyer. Megjithëkëtë, pa e dëgjuar deri në fund lajmin, kishte mbathur këpucët me taka dhe kishte hedhur kryes shaminë e zezë që e vinte vetëm kur shkonte për kryeshëndoshë. Im atë, i cili i kishte dëgjuar të gjitha që prej shtratit, hyri me pizhama në dhomën e bukës dhe e pyeti i shqetësuar se ku po shkonte.

- Të paralajmëroj ndrikull Plasidën, - u gjegj ajo. - Nuk është e drejtë që të gjithë ta dinë se asaj do t'i vrasin të birin dhe vetëm ajo të mos e dijë.

- I kemi tanët edhe ata, po edhe Vikariot, - tha im atë.

- Gjithmonë duhet mbajtur ana e të vdekurit, - ia preu ajo.

Vëllezërit e mi të vegjël zunë të dilnin nga dhomat e tjera. Ata më të vegjlit, si të ndinin në ajër flatrimin e tragjedisë, saj, s'ua vari fare, ashtu siç nuk ia vari edhe të shoqit.

- Prit se po vishem, - i tha ai.

Ajo tashmë kishte dalë në rrugë. Im vëlla Haimeja, që atëherë s'kishte mbushur as të shtatat, qe i vetmi që ishte veshur e qe bërë gati për në shkollë.

- Shko ti me të, - e urdhëroi im atë.

Haimeja vrapoi pas saj pa e ditur se ç'po ndodhte, as se ku po shkonin dhe iu mbërthye pas gishtërinjve. "Ecte dhe fliste me vete, më tregoi Haimeja. - Mizeriet, mërmëriste me zë të ulët, derrat e derrit, që vetëm për të zeza u punon mendja". Madje as e vinte re që kishte kalamanin për dore. "Njerëzit kushedi thoshin se mos isha çmendur, - më tha ajo. - Gjëja e vetme që mbaj mend ishte se dëgjoja prej së largu një katrahurë të madhe, sikur dasma të paskësh filluar sërishmi dhe se të gjithë rendnin në drejtim të sheshit." Shpejtoi hapin me atë vendosmërinë që i hipte kur qe fjala për jetën e një njeriu, derisa dikujt, që rendte përkundrejt, i erdhi keq për të.

- Mos u lodh kot, Luisa Santiaga, - i thirri kalimthi. - E vranë.

***

Bajardo San Romani, djaloshi që ktheu nusen, qe dukur për herë të parë në fshat gushtin e vitit të kaluar, gjashtë muaj përpara dasmës. Kishte ardhur me anijen që vinte çdo javë, me një çantë lëkure të stolisur me folla argjendi, që shkonin me tokëzën e lajlet e rripit si dhe me tokat e çizmeve. Të tridhjetat i kishte mbushur, por s'i tregonte, se belin e kishte të hollë si një tolero rishtar, sytë të praruar dhe lëkurën si të regjur në afsh të salnitrit. Kishte ardhur me një xhaketë të shkurtër dhe me një palë pantallona shumë të ngushta, të dyja prej lëkure viçi, dhe me një palë dorashka prej lëkure keci të së njëjtës ngjyrë. Magdalena Oliveri kishte udhëtuar në një anije me të dhe nuk ia pat shqitur sytë gjatë gjithë udhëtimit. "Dukej si pederast, - më tha. - Dhe gjynah, se qe një bukurosh që t'i merrje kokën." Ajo s'ishte e para që e mendoi dhe as e fundit që e kuptoi se Bajardo San Romani s'qe nga ata burra që njihen me një të parë.

Në të dalë të gushtit, ime ëmë, në letrën që më dërgonte në kolegj, vërente kalimthi: "Ka ardhur një njeri i çuditshëm." Në letrën tjetër më sqaronte: "Njeriu çuditshëm quhej Bajardo San Roman dhe të gjithë thonë se është magjepsës, por unë nuk e kam parë." Askush nuk e mori vesh ndonjherë përse kishte ardhur. Dikujt, që nuk e kishte mposhtur dot tundimin dhe e kishte pyetur për këtë pak përpara dasmës, i qe përgjigjur: "Kam bredhur fshat më fshat për të kërkuar nuse." Mund edhe të ishte e vërtetë, por me të njëjtën lehtësi ai mund të kishte dhënë çdo lloj përgjigjeje, sepse kishte një mënyrë të foluri, me të cilën më tepër i fshihte mendimet sesa i zbulonte.

Atë mbrëmje që erdhi, la të kuptohej në kinoteatër se qe inxhinier hekurudhash dhe foli për domosdoshmërinë e ndërtimit të një hekurudhe në brendësi të vendit, për të shpëtuar nga trillet e lumit. Të nesërmen iu desh të hiqte një telegram dhe e transmetoi vetë, duke i mësuar telegrafistit edhe një sekret për të përdorur sërishmi pilat e

harxhuara. Me të njëjtën siguri bisedoi për sëmundjet e brezit kufitar me një mjek ushtarak, që kishte kaluar në ato anë për rekrutim. Ia kish ënda gostitë e zhurmshme e të pafundta, e hiqte mirë të pirët, në grindje ndërhynte për pajtim dhe nuk i pëlqenin ngacmimet me duar. Një të diel pas meshe u hëngër me notarët më të zotë, që qenë të shumtë, dhe i la njëzet pashë mbrapa ata më të mirët, vajtje e ardhje gjatë lumit. Ime ëmë ma tregonte këtë në një nga letrat e saj, të cilën e përfundonte me një vërejtje nga ato që i ka të vetat: "Me ç'thuhet, noton edhe në flori." Dhe në të vërtetë flitej se Bajardo San Romani jo vetëm që mund të bënte çdo gjë, dhe ta bënte shumë mirë, por edhe kishte të ardhura të pashtershme financiare.

Ime ëmë i jepte bekimin përfundirnisht në një letër që më shkruante në tetor: "Njerëzit e duan shumë, më thoshte, - se është i ndershëm e zemërmirë; të dielën e shkuar u kungua mëgjunjazi dhe ndihmoi në thënien e meshës latinisht." Asokohe nuk lejohej kungimi më këmbë dhe oficet bëheshin vetëm latinisht, por ime ëmë, kur s'don të lërë asgjë pa ia gjetur bishtin, i ka zakon këto saktësime të panevojshme. Sidoqoftë, pas këtii vendimi shugurues, më shkroi edhe dy letra të tjera, në të cilat nuk e zinte më në gojë Bajardo San Romanin, as kur u mor vesh prej të gjithëve se ai deshte të martohej me Anhela Vikarion. Vetëm shumë kohë pas martesës fatkeqe, ajo më rrëfeu se e kishte parë nga afër kur pat qenë tepër vonë për të korrigjuar letrën e tetori, dhe se sytë e tij të praruar i kishin kallur datën.

- Më shëmbëlleu si goftëlargu, - më tha, dhe ti vetë më pate thënë se gjëra të tilla nuk duhen shkruar.

Unë e njoha Bajardo San Romanin pak më vonë se ajo, kur vajta në shtëpi për pushimet e kërshëndellave, dhe nuk m'u duk i çuditshërn sa ç'e bënin. M'u duk tërheqës, po, por shumë larg atij përshkrimit idilik

të Magdalena Oliverit. Qe më serioz nga ç'mund ta pandehje prej çapkënirave të tij, me një tendosje të brendshme, që mezi arrinte ta fshihte nën harenë e tepruar. Por, ç'është më kryesorja, m'u duk një njeri mjaft i pikëlluar. Në atë kohë e kishte bërë mend fejesën e tij me Anhela Vikarion.

Asnjëherë nuk u mor vesh mirë se si u njohën. Pronarja e pensionit për beqarë, ku banonte Bajardo San Romani, tregonte se ky po bënte gjumin e pasdrekes në një karrige përkundëse të sallonit, aty nga fundi i shtatorit, kur Anhela Vikarioja me të ëmën kishin kaluar përmes sheshit me dy kanistra me lule artificiale. Bajardo San Romani qe zgjuar përgjysmë, i kishte parë dy gratë e veshura kokë e këmbë përzishëm, saqë dukeshin si të vetmet qenie të gjalla në atë shkreti vegullore të pasdrekës, dhe kishte pyetur kush ishte ajo më e reja.

Pronarja i qe përgjigjur se ishte vajza më e vogël e gruas që ecte në krah me të dhe se quhej Anhela Vikario. Bajardo San Romani i kishte ndjekur me sy deri në të dalë të sheshit.

- I shkoka emri[4], - kishte thënë.

Pastaj pat mbështetur sërishmi kokën në shpinën e karriges dhe pat mbyllur sytë.

- Kur të zgjohem, - kishte thënë, - më kujtoni që do të martohem me të.

Anhela Vikarioja më tregoi se pronarja e pensionit kishte folur për këtë ngjarje qysh më përpara se Bajardo San Romani t'i shfaqte dashurinë. "Më hyri data", më tha. Tre vetë që gjendeshin në pension pohonin se kjo ngjarje pat ndodhur vërtet, ndërsa katër të tjerë thoshin se jo. Mirëpo të gjitha motërzimet puqeshin në faktin që Anhela Vikarioja dhe Bajardo San Romani qenë parë për së pari ditën e festës

[4] *Lojë fjalësh nga sp. Angel (ëngjëll dhe lat. Vicarious përkujdesës, ndihmues)*

kombëtare në tetor, gjatë një panairi bamirësie, në të cilën ajo ishte ngarkuar të drejtonte një llotari. Bajardo San Romani kishte shkuar në panair dhe kishte mësyer drejt e te vitrina me fustanin e zi me mëngë të gjata e të mbyllur deri në fyt. Ai e kishte pyetur sa kushtonte gramafoni i larzuar me sedef, që do të bëhej joshja më e madhe e panairit. Ajo i qe përgjigjur se nuk ishte për t'u shitur, por për t'u vënë në llotari.

- Aq më mirë, - i kishte thënë ai. - Kështu është më lehtë dhe bie më lirë.

Anhela Vikarioja më rrëfeu se ai kishte arritur t'i linte njëfarë mbrese, por jo ta prekte në ndonjë ndjenjë të veçantë. "S'i shihja dot me sy burrat kapadainj, dhe mburravec si ai s'kisha parë ndonjëherë", më tha duke sjellë ndër mend atë ditë. "Pastaj thashë se mos ishte çifut." E mori edhe më tepër inat kur, në mes të ankthit të përgjithshëm, lexoi llotarinë dhe ajo me të vërtetë i kishte rënë Bajardo San Romanit. As që mund t'i shkonte mendja se ai, vetëm për t'u dukur para saj, i kishte blerë të gjithë numrat.

Atë natë, kur u kthye në shtëpi, Anhela Vikarioja gjeti aty gramafonin, të mbështjellë me letër dhuratash dhe të stolisur me një fjongo organxini. "Kurrsesi nuk e gjeta dot se nga e mori vesh që unë kisha ditëlindjen", më tha. Mezi ua kish mbushur mendjen prindërve që nuk i kish dhënë asnjë shkas Bajardo San Romanit për t'i dërguar një dhuratë të tillë, për më tepër kaq sheshazi, sa t'u binte në sy të gjithëve. Dy vëllezërit e saj të mëdhenj, Pedro dhe Pablo, e shpunë gramafonin në pension për t'ia kthyer të zotit dhe e bënë këtë me aq bujë, saqë s'mbeti asnjë nga ata që e kishin parë atë të shkonte, të mos e shihte edhe të kthehej. Vetëm një gjë nuk kishte llogaritur familja e Anhela Vikarios: fuqinë joshëse të Bajardo San Romanit, së cilës nuk mund t'i bëje dot ballë. Binjakët u kthyen në shtëpi vetëm në të gdhirë të ditës

tjetër, të rrumbullosur nga të pirët, duke sjellë përsëri me vete gramafonin e tok me të edhe vetë Bajardo San Romanin për të vazhduar dafrungën në shtëpi.

Anhela Vikarioja ishte bija e vogël e një familjeje me të ardhura të pakta. I ati, Ponso Vikario, ishte një argjendar i varfër që e kishte humbur të pamat duke punuar ditë e natë filigrane ari për të ruajtur nderin e familjes. E ëma, Purisima del Karmen, pat qenë mësuese shkolle deri kur qe martuar. Pamja e saj e butë dhe disi e pikur ia fshihte mjaft mirë rreptësinë e karakterit. "Dukej si një murgeshë", sillte ndër mend Mersedesi. I qe përkushtuar me aq vetëmohim kujdesjes së të shoqit dhe rritjes së fëmijëve, saqë ata që kishte përreth nganjëherë harronin se edhe ajo qe gjallë. Dy vajzat e mëdha ishin martuar mjaft vonë. Përpara binjakëve kishin pasur edhe një vajzë që u kish vdekur nga malarja, dhe për dy vjet rresht patën mbajtur një zi të lehtë në shtëpi e të rreptë në rrugë. Djemtë u rritën për t'u bërë burra. Vajzat u edukuan për t'u martuar. Dinin të qëndisnin në gjergjef, të qepnin në makinë, të punonin oja me grep, të lanin e të hekurosnin, të bënin lule artificiale, të gatuanin lloj-lloj ëmbëlsirash, si dhe të shkruanin ftesa fejese. Ndryshe nga vajzat e kohës, që i kishin lënë pas dore ritualet e vdekjes, katër vajzat e Vikariove ishin ustallesha në artin e lashtë të përkujdesjes së të sëmurëve, të ngushëllimit të njerëzve në hjekë, të qefinosje së të vdekurve. Vetëm për një gjë i qortonte imë ëmë: për zakonin e të krehurit para se të binin për të fjetur. "Nuk bën të krihesh natën, çupa, - u thosh ajo, - se vonohen detarët." Duke hequr këtë huq, mendonte ime ëmë, s'kishte në botë çupa më të edukuara se ato. "S'e kanë shoqen, - përsëriste shpesh. Lum ai burrë që do t'i fusë në derë, se janë rritur për të vuar." Mirëpo burrave që u martuan me dy vajzat e mëdha u polli belaja: gratë e tyre shkonin kudo tok, organizonin mbrëmje vallëzimi

vetëm për gra dhe orë e çast qenë gati të gjenin synime të liga prapa çdo veprimi të burrave.

Anhela Vikarioja qe më e bukura e të katrave dhe ime ëmë thoshte se pat lindur si mbretëreshat e mëdha që i ka marrë historia: me kordonin e krthizës rreth qafës. Por ajo pamje e përhumbur që kishte, si dhe varfëria shpirtërore vinin duke u shtuar me kalimin e viteve. Unë e takoja përvit kur vija për pushimet e kërshëndellave, dhe sa herë e shihja në dritaren e shtëpisë, ku ulej pasditeve duke punuar me grep ose duke kënduar me fqinjat e saj valse lëneshash, më dukej edhe më e shpëlarë, edhe më e pakuptimtë. "Kjo jot kushërirë torollaçka, - më thoshte një ditë Santiago Nasari, - është bërë për t'i varur teneqen." Njëherë, pak kohë pasi patën hequr zinë e motrës, e hasa për herë të parë në rrugë me fustan të zakonshëm, me flokë te dredhur dhe mezi u besova syve. Por ky qe një vegim i çastit: me kalimin e viteve ajo bëhej gjithnjë më shpirtzbrazët, kështu që, kur u mor vesh se Bajardo San Romani deshte të martohej me të, shumë vetë menduan se do të kishte në këtë mes ndonjë dredhi prej jabanxhiu.

Familja e Vikariove jo vetëm që e mori seriozisht propozimin, por e priti me gëzim të madh, me përjashtim të Pura Vikarios, e cila vuri si kusht që Bajardo San Romani të tregonte prejardhjen e tij. Gjer më atëherë asnjeri nuk e pat ditur se kush ishte. E shkuara e tij njihej vetëm duke filluar prej asaj mbrëmjeje kur pat zbritur nga anija i veshur si artist, dhe ai vetë qe aq i fshehtë për punë të prejardhjes së tij, saqë edhe trillimet më të çmendura mund të merreshin për të vërteta. Ç'nuk u tha për të: se paskësh mbjellë tmerrin nëpër Kasanare si komandant i një njësie ushtarake, se qenkësh arratisur nga Kajena, se e paskëshin parë në Pernambuko duke dhënë shfaqje me një çift arinjsh të zbutur dhe se paskësh nxjerrë nga deti në Ngushticën e Erërave të mbeturat e

një galeoni spanjoll të ngarkuar me flori. Bajardo San Romani gjeti një zgjidhje të thjeshtë për t'u dhënë fund gjithë këtyre thashethemeve: pruri në fshat krejt familjen e vet.

Ishin katër vetë: babai, nëna dhe dy motra zhurmëmëdha. Erdhën me një "Ford-T" me targë zyrtare, boria e të cilit gagariti si patok rrugëve në ora njëmbëdhjetë të mëngjesit. E ëma, Alberta Simonds, një mulate e bëshme nga Kurasao, që ende e fliste spanjishten të përzier me dialektin *papiamento*[5], në të ritë e saj qe shpallur më e bukura ndër 200 më të bukurat e ishujve Antilë. Motrat - në lule të rinisë - ngjanin si dy pela rioshe të pashaluara. Por karta kryesore qe i ati, gjeneral Petronio San Romani, hero i luftërave civile të shekullit të kaluar, një nga figurat më të shquara të regjimit konservator, ai që i pat dhënë dërrmën kolonel Aureliano Buendias, duke e shpartalluar në betejën e Tukurinkës. Ime ëmë qe e vetmja që nuk doli ta përshëndeste, kur u mor vesh se kush qe. "Çifti të martohej e të trashëgohej, - më tha. - Tjetër qe kjo e tjetër qe t'i shtrëngoje dorën një njeriu që kishte dhënë urdhër t'i shtinin prapa shpine Herineldo Markesit." Me t'u shfaqur te dritarja e veturës duke përshëndetur me sombreron e bardhë, të gjithë e njohën menjëherë prej portreteve të tij aq të përhapura. Kishte veshur një kostum linoje ngjyrë gruri, kishte mbathur një palë potina kamoshi me lidhësa tërthor dhe kishte vënë një palë syze ari të kapura në samar të hundës e të mbajtura me një zinxhirkë në filiqen e jelekut. Në jakë të kostumit kishte medaljen e trimërisë, ndërsa në dorë një bastun në dorëzën e të cilit qe gdhendur shqyti kombëtar. Zbriti i pari nga vetura, i mbuluar kokë e këmbë nga pluhuri i hamullt i rrugëve tona të këqija dhe, me t'u dhënë përpara të tjerëve, të gjithë e kuptuan se Bajardo San Romani do të martohej me kë t'i deshte qejfi.

[5] *Dialekt i spanjishtes që flitet në ishullin e Kurasaos.*

Por nuk deshte Anhela Vikarioja të martohej me të. "Më dukej tepër i fuqishëm për mua", më tha. Veç kësaj, Bajardo San Romani as që qe përpjekur ta ngashënjente, por sikur u pat bërë magji gjithë familjes. Anhela Vikarioja nuk e harroi kurrë tmerrin e asj nate kur prindërit dhe motrat e saj të mëdha, së toku me burrat e tyre, u mblodhën në sallon dhe e shtrënguan të pranonte të martohej me një njeri që ajo e kishte parë a s'e kishte parë një herë. Binjakët qëndruan mënjanë. "Na u dukën punë grash", më tha Pablo Vikarioja. Arsyeja përfundimtare që përdorën prindërit ishte që një familje si e tyrja, me të ardhura më se modeste, nuk kishte të drejtë ta përçmonte këtë dhuratë të fatit. Anhela Vikarioja mezi guxoi ta hidhte fjalën se ajo nuk ndiente asgjë për atë burrë, kur e ëma ia mbylli gojën menjëherë:

- Edhe dashuria mbete.

Ndryshe nga fejesat e asaj kohe, që ishin të gjata e të mbikëqyrura, fejesa e tyre zgjati vetëm katër muaj. Kështu deshte Bajardo san Romani. Më e shkurtër s'kish si bëhej, mbasi Pura Vikarioja kishte kërkuar të prisnin derisa familja e tyre të hiqte zinë. Por koha fluturoi pa u kuptuar. Bajardo San Romani ishte jashtëzakonisht i shkathët për t'i rregulluar punët e veta. “Një natë më pyeti se cila shtëpi e fshatit më pëlqente më shumë, - më tregoi Anhela Vikarioja. Dhe unë, pa e ditur përse më pyeste, iu përgjigja se shtëpia më e bukur ishte vila e vejanit Ksius.” Edhe unë vetë ashtu do të isha përgjigjur. Vila ndodhej majë një kodre, e rrahur prej erërave, dhe nga taraca e saj shihej parajsa e paskajme e moçalishteve të mbuluara me anemona në ngjyrë manushaqe, madje në ditët e kthjellta syri të rrokte gjer edhe synorin e kulluar të detit të Karaibeve dhe transatlantikët turistikë që rrihnin linjën e Kartahena de Indias. Bajardo San Romani vajti qysh atë natë në

Klubin Shoqëror dhe u ul në tryezën e vejanit Ksius për të luajtur një dorë domino.

- Dëgjo, vejan, - tha, - po ta ble shtëpinë.

- Unë nuk e shes, - iu gjegj vejani.

- E ble me të gjitha ç'ka brenda.

Vejani Ksius i shpjegoi me një mirësjellje të modës së vjetër e me fjalë të zgjedhura se orenditë e shtëpisë i pat vënë bashkëshortja e tij gjatë një jete gjithë sakrifica dhe ai i ruante ato si të vetmet kujtime prej saj. "Fliste me zemër në dorë, - më tha doktor Dionisio Iguarani, që po luante tok me ta. - Unë isha i sigurt që ai më mirë vdiste, sesa të ndahej prej asaj shtëpie ku pat qenë i lumtur për më se tridhjetë vjet." Edhe Bajardo san Romani i dha të drejtë.

- Në rregull, - i tha. Atëherë shitma shtëpinë bosh.

Vejani Ksius s'pranonte që s'pranonte. Pas tri netësh, Bajardo San Romani erdhi sërish te tryeza e dominosë, edhe më i vendoçur.

- Dëgjo, vejan, - filloi përsëri. - Sa bën shtëpia?

- Për mua s'ka të çmuar.

- Jep një pazar.

- Më vjen keq, Bajardo, - tha vejani. Ju të rinjtë nuk i kuptoni arsyet e zemrës.

Por Bajardo San Romani s'ngurroi asnjë grimë.

- Ta zëmë pesë mijë pesës.

- Lëri këto, - ia priti vejani. - Shtëpia s'vlen aq para.

- Dhjetë mijë, - vazhdoi Bajardo San Romani. - Këtu ku jemi trung në dorë.

Vejani e këqyri me sytë të mbushur me lot. "Qante nga marazi, më tha doktor Dionisio Iguarani që, përveçse njeri i barnave, ishte edhe njeri i letrave. Përfytyro të të bien aq shumë para në dorë dhe të thuash

"jo" vetëm për hir të një dobësie shpirtërore." Vejani Ksius nuk nxori dot zë, vetëm mohoi me një të tundur të kokës.

- Atëherë më bëj edhe një nder të fundit, - i tha Bajardo San Romani. - Pritmë këtu pesë minuta.

Dhe njëmend, pas pesë minutash u kthye në klub me çantën prej lëkure të stolisur me folla argjendi dhe vuri mbi tryezë dhjetë tufa kartëmonedhash njëmijëshe, ende të shtrënguara në shiritat me vulën e Bankës Kombëtare. Vejani Ksius vdiq pas dy vjetësh. "Prej kësaj vdiq, - thoshte doktor Dionisio Iguarani. Ishte më i shëndoshë se ne, por kur e dëgjova, dukej sikur i gurgullonin lotët brenda zemrës." Jo vetëm që ia shiti shtëpinë me të gjitha ç'kish brenda, por i qe lutur Bajardo San Romanit që ky t'ia paguante të hollat pak e nga pak, mbasi nuk i kishte mbetur për ngushëllim as një baule ku të mund ta ruante gjithë atë pasuri.

Askujt nuk ia pat marrë mendja që Anhela Vikarioja të mos ishte e virgjër. Askush s'dinte të kishte pasur ndonjë dashnor dhe ajo qe rritur, së toku me të motrat, nën pushtetin e hekurt të nënës. Edhe kur s'kishin rnbetur as dy muaj për t'u martuar, Pura Vikarioja nuk e kishte lejuar të shkonte vetëm me Bajardo San Romanin për të parë shtëpinë ku do të banonin, por ajo vetë dhe babai i verbër e kishin shoqëruar për t'i ruajtur nderin. "I lutesha zotit vetëm që të më jepte fuqi për të vrarë veten, - më tha Anhela Vikarioja. Por nuk më dha." Aq e dëshpëruar ishte saqë kishte vendosur t'i rrëfehej së ëmës për të shpëtuar nga ajo torturë e tmerrshme, por dy shoqkat e saj të ngushta, të cilat e ndihmonin për të bërë lule ngjat dritares, ia prishën mendjen. "Iu binda atyre verbërisht, - më tha, se ma mbushën mendjen që qenë ustallesha për t'ua hedhur burrave." Ato e siguruan se pothuaj të gjitha vajzat e humbnin virgjërinë aksidentalisht qysh në fëmijëri. E bindën se edhe

burrat më kryeneçë pranonin çdo gjë, me kusht që askush të mos e merrte vesh. Ia mbushën mendjen, tek e fundit, se shumica e burrave e presin me frikë natën e parë të martesës, saqë nuk mund të bëjnë kurrgjë pa ndihmën e gruas dhe në çastin vendimtar as që mund të përgjigjen për veprimet e tyre. "I besojnë vetëm asaj çka shohin në çarçaf", i thanë. I mësuan lloj-lloj marifete ndrikullash se si ta mashtronte burrin e ardhshëm, duke i dhuruar diçka të humbur prej kohe, dhe se si mëngjesin e parë të martesës të nderte në oborr çarçafin me njollën e nderit.

Me këtë shpresë u martua. Bajardo San Romani, nga ana e tij, duhej të ishte martuar me mendimin se po e blinte lumturinë me peshën e jashtëzakonshme të pasurisë së tij, mbasi sa më tepër shtoheshin përgatitjet e dasmës, aq më shumë ide fantastike i lindnin në kokë për ta bërë edhe më të madhe. Kur u hap lajmi për vizitën e ipeshkvit, u orvat ta shtynte dasmën edhe një ditë, në mënyrë që t'ua vinte ai kurorën, por Anhela Vikarioja kundërshtoi. "E vërteta është, - më tha ajo, - se nuk desha të merrja bekimin e një njeriu që priste vetëm lafshat për supë dhe pjesët e tjera të gjelit i hidhte." Megjithëkëtë, edhe pa bekimin e ipeshkvit, dasma u nxe aq shumë e mori aq zjarr, saqë i doli duarsh edhe vetë Bajardo San Romanit dhe frerët e saj i morën të ftuarit.

Gjeneral Petronio San Romani dhe familja e tij erdhën kësaj radhe me anijen e ceremonive të Kongresit Kombëtar, që qëndroi e lidhur për port derisa mbaroi festa, dhe së toku me ta erdhën edhe plot njerëz të shquar megjithëkëtë, as që ranë në sy mes pështjellimit të fytyrave të reja. Aq shumë peshqeshe sollën, saqë u desh meremetuar ndërtesa e lënë pas dore e centralit të parë elektrik, për të futur ato më të mëdhatë, ndërsa të tjerat i shpinin drejt e në ish-shtëpinë e vejanit Ksius, që qe bërë gati për të pritur të sapomartuarit. Dhëndrit i dhuruan një veturë me mbulesë të ngritshme, me emrin e tij të gdhendur me

shkronja gotike përposh markës së fabrikës. Nuses i dhuruan një kuti me një servil tryeze për njëzet e katër vetë, të tërin prej ari. Prunë gjithashtu një trupë valltarësh dhe dy orkestra valsesh që të vrisnin veshin mes ahengxhinjve të vendit, lodërtarëve e fisarmonicistëve të shumtë.

Familja Vikario banonte në një shtëpi të thjeshtë, me mure prej plitharësh dhe me çati prej degësh palme, ku qenë çelur dy baxha në të cilat ngrinin foletë dallëndyshet janar për janar. Nga përpara kishte një hajat të zënë pothuaj krejt me saksi lulesh dhe një oborr të madh me pemë frutore e pula që bridhnin azat. Në fund të oborrit binjakët kishin një thark me "gurin e flijimit" dhe tryezën për rrjepje. Rritja dhe therja e derrave qe bërë një burim i mirë të ardhurash për shtëpinë, qysh kur Ponsio Vikarios i pat të pamat. Kësaj pune i hyri Pedro Vikarioja, por kur ky shkoi të bënte ushtrinë, e mësoi zanatin e kasapit edhe vëllai binjak.

Kthinat e shtëpisë mezi mjaftonin për familjen, prandaj motrat e mëdha, kur morën vesh se ç'dasmë e madhe do të bëhej, u përpoqën se mos gjenin ndonjë shtëpi me qira. "Përfytyro, tha Anhela Vikarioja, - ia kishin vënë syrin shtëpisë së Plasida Lineros, por për fat të mirë prindërit ngulën këmbë në atë avazin e përhershëm se bijat e tyre ja martohen në atë kasolle ku janë rritur, ja s'martohen fare." Kështu që shtëpia u lye edhe një herë me ngjyrën e verdhë që kishte pasur më parë, dyert u ndreqën, dyshemet u meremetuan, u bë me një fjalë siç e donte radha e sëra e asaj dasme madhështore. Binjakët i hoqën derrat nga oborri, e pastruan tharkun me gëlqere të pashuar, por përsëri me vend ishin keq. Tek e fundit, me këmbënguljen e Bajardo San Romanit, u prish gardhi i oborrit, u morën vesh me fqinjët që të kërcehej edhe në

shtëpitë e tyre, dhe në hijen e *ternarindëve* u vendosën tryeza të sajuara aty për aty.

E vetmja ngatërresë mëngjesin e dasmës ishte një vonesë dyorëshe e dhëndrit, kur duhej të vinte për të marrë nusen, dhe kjo nuk kishte pranuar të vishej nusërisht pa ardhur ai. "Do të kisha qenë e lumtur, më tha ajo, sikur të mos vinte fare, por jo të më linte të veshur". Dhe kjo frikë e saj qe krejtësisht e natyrshme, mbasi s'kishte turp më të madh për një grua sesa të mbetej si hu gardhi veshur me fustanin e nusërisë. Nga ana tjetër, fakti që Anhela Vikarioja pakësh guxuar të vinte vellon me luleportokallet pa qenë e virgjër, do të merrej më pas si një përdhosje e simboleve të dëlirësisë.

Ime ëmë qe e vetmja që e quajti veprim të guximshëm këtë qëndrim të saj të çiltër deri në çastin e fundit. "Në atë kohë, - më shpjegoi, - zoti i shihte të gjitha ç'ndodhnin. " Përkundrazi, asnjeri nuk e mori dot vesh se cili qe qëndrimi i vërtetë i Bajardo San Romanit. Qysh kur u duk me frak e me cilindër e gjersa u zhduk nga vallëzimi me krijesën e tij të dashur, ai kishte qenë mishërimi i vërtetë i një bashkëshorti të lumtur.

As qëndrimi i vërtetë i Santiago Nasarit nuk u mor dot vesh kurrë. Unë qeshë me të gjatë gjithë kohës, në kishë dhe në gosti, së toku me Kristo Bedojën dhe tim vëlla Luis Enriken, dhe asnjëri prej nesh nuk pikasi as edhe më të voglin ndryshim tek ai. Më është dashur ta përsëris shumë herë këtë, se të katër së bashku qemë rritur, patëm vajtur në shkollë, së bashku kishim kaluar pushimet verore dhe ishte e pabesueshme që ndonjëri prej nesh të mos u paskësh treguar të tjerëve ndonjë të fshehtë, për më tepër një të fshehtë kaq të madhe.

Santiago Nasari qe njeri i qejfeve dhe qejfin më të madh e bëri mu në prag të vdekjes së vet, duke përllogaritur shpenzimet e dasmës. Sipas llogaritjeve të tij, zbukurimet me lule në kishë kishin një vlerë të

barabartë me katërmbëdhjetë varrime të klasit të parë. Kjo hollësi s'm'i shqit nga mendja për shumë vite me radhë, mbasi Santiago Nasari më pat thënë shpesh që erën e luleve në një vend të mbyllur ai e lidhte vetiu me vdekjen dhe atë ditë më kishte thënë përsëri ndërsa hynim në kishë: "Nuk dua lule në varrimin tim", pa i shkuar ndër mend se qysh të nesërmen unë do të kujdesesha që ai të mos kishte lule në varrim. Gjatë udhës nga kisha në shtëpinë e Vikariove, bëri llogaritë e kurorave me lule me të cilat qenë stolisur rrugët, llogariti çmimin e muzikës e të fishekzjarrëve, madje edhe të orizit që na hodhën me grushte në festë e sipër. Në zhegun e drekës të sapomartuarit i ranë një herë rreth e përqark oborrit, Bajardo San Romani qe bërë mik për kokë me ne, mik të piri, siç thuhej asokohe, dhe me ç'dukej e ndiente veten për mrekulli në tryezën tonë. Anhela Vikarioja, pa vellon dhe pa kurorën, me atë fustanin prej satenin të bërë ujë në djersë, pat marrë menjëherë pamjen e gruas së martuar. Santiago Nasari ishte duke bërë llogaritë dhe i tha Bajardo San Romanit se dasma gjer në atë çast po kushtonte rreth nëntë mijë pesës. U pa qartas se Anhela Vikarios kjo i erdhi hidhët. "Ime ëmë më kishte mësuar se faqe botës nuk duhen bërë muhabete parash", më tha. Ndërsa Bajardo San Romani e priti vërejtjen me dashamirësi, madje me njëfarë sqime.

- Aty afër, - tha, - por dasma sapo ka filluar. Kur të mbarojë, do të ketë kushtuar gati dyfishin.

Santiago Nasari vendosi të përllogariste deri në qindarkën e fundit se sa i vërtetë do të ishte ky parashikim dhe për këtë jeta i doli me tamam. Kështu, me të dhënat e fundit që Kristo Bedoja i dha të nesërmen në port 45 minuta para se të vdiste, u provua se parashikimi i Bajardo San Romanit kishte qenë i saktë.

Unë për vete ruaja një kujtim mjaft të vagullt nga dasma, sa pa vendosur ta rindërtoja atë copë pas cope sipas kujtimeve të të tjerëve.

Për vite me radhë vazhdoi të tregohej në shtëpinë tonë se si im atë kishte rrokur edhe një herë violinën e rinisë për nder të të sapomartuarve, se si ime motër murgesha pat kërcyer një *merengë* me atë petkun e saj si kambanë dhe se si doktor Dionisio Iguarani, kushëriri i parë i sime ëme, kishte gjetur për vete një vend në anijen zyrtare, që të mos ndodhej aty të nesërmen kur të vinte ipeshkvi. Gjatë hetimeve të bëra për këtë kronikë, mblodha edhe shumë dëshmi të ndryshme që dilnin nga korniza e saj dhe midis tyre kujtimin e hireve të motrave të Bajardo San Romanit. Fustanet e tyre prej kadifeje, me krahë të mëdhenjë si flutura, kapur me karfica ari te shpatullat, kishin tërhequr vëmendjen më tepër sesa tufëza e pendëve mbi kapelë e atit të tyre dhe gjoksi i tij i mbuluar kryq e tërthor me dekorata. Shumë vetë kujtonin edhe se si, në dehje e sipër, i kisha propozuar për martesë Mersedes Barçës, kur ajo sapo kishte mbaruar filloren. Këtë ma kujtoi edhe ajo vetë kur u martuam pas katërmbëdhjetë vjetësh. Mbresa më e fortë që ruajta prej asaj të diele të pakëndshme ishte figura e plakut Ponsio Vikario, të ulur fill vetëm në një fron në mes të oborrit. E patën vënë aty duke menduar se mbase ai qe vendi i nderit, por të ftuarit një e dy përplaseshin me të, e ngatërronin me ndonjë tjetër, i nclërronin vendin që të mos i pengonte. Plaku lëvizte qark kokën e bardhë borë me shprehjen e përhumbur të një njeriu që s'ka shumë që është verbuar, duke iu përgjigjur pyetjeve që nuk i bëheshin atij dhe duke u kthyer përshëndetjet atyre që as ia varnin, i lumtur brenda rrethit të vet të harrimit, me këmishën e bërë karton nga kollarisja dhe me bastunin prej *guajakani* që ia kishin blerë me rastin e dasmës.

Ceremonia zyrtare mbaroi në gjashtë të mbrëmjes, kur të ftuarit e nderit ikin. Anija u largua me drita të ndezura, duke lënë nga pas një

çurkajë valsesh me pianolë dhe ne për një grimë mbetëm të mekur, si të ishim varur mbi një humnerë pasigurie, derisa erdhëm në vete dhe u lëshuarn në vorbullën e dëfrimit. Pas pak u dukën të porsamartuarit në veturën me mbulesë të ngritur, duke çarë me zor përmes kallaballëkut. Bajardo San Romani hodhi fishekzjarre, piu disa gliënjka raki nga shishet që i zgjatnin dhe zbriti prej veturës bashkë me Anhela Vikarion për të hyrë në vallëzimin e *kumbiambës*. Tekefundit, bëri zë që të vazhdonin të kërcenim e të dëfrenim për hesap të tij, derisa të kishim takat, ndërsa gruan e kapluar nga frika e mori ta shpinte në shtëpinë e ëndrrave të veta, ku pat qenë aq i lumtur vejani Ksius.

Aty nga mesnata dasmorët zunë të shpërndaheshin, kallaballëku po pakësohej dhe mbeti hapur vetëm dyqani i qumështit i Klotilde Armentës në një cep të sheshit. Santiago Nasari, unë, im vëlla Luis Enrike dhe Kristo Bedoja vajtëm për të gjetur ngushëllim në shtëpinë e zemërgjerës Maria Alehandrina Servantesit. Aty u ndodhën, mes të tjerëve, edhe vëllezërit Vikario, që pinë me ne e kënduam me Santiago Nasarin pesë orë para se ta vrisnin. Duhej të kishin mbetur aty-këtu grurthe që vazhdonin zdërhalljen pas qejfit të tyre, se nga çdo anë vinin copëza ahengjesh dhe zënkash të largëta, që u tretën e u shuan dalëngadalë pak përpara se të dëgjohej uturima e anijes së ipeshkvit.

Pura Vikarioja i rrëfeu sime ëme se pat rënë aty nga ora njëmbëdhjetë e natës, mbasi qe përpjekur së toku me dy vajzat e mëdha të rregullonte ç'të mundte nga gjithë ajo rrërnujë e dasmës. Rreth orës dhjetë, kur në oborr kishin mbetur ende një dorë sarhoshësh që këndonin, Anhela Vikarioja kishte dërguar dikë që t'i sillte valixhen e vogël me plaçka vetjake, e cila ndodhej në dollapin e rrobave të dhomës së saj. E ërna kish dashur t'i dërgonte edhe një valixhe me ndërresa e tesha të përditshme, por i dërguari kishte ngut. E pat zënë gjumi top kur

i trokitën. "Qenë tri të trokitura të rralla, - i tregoi sime ëme, tamam Si ato të mandatave të zeza." E kishte hapur derën pa ndezur dritë, që të mos zgjonte njeri, dhe të qarkuar nga vezullimi i fenerit të rrugës kishte dalluar Bajardo San Romanin, me këmishën e mëndafshtë të shkopsitur dhe me pantallonat ngjyra-ngjyra me aski llastiku. "Kishte një ngjyrë të jeshiltë, si nëpër ëndrra", i tha Pura Vikarioja sime ëme. Anhela Vikarioja qëndronte në hije dhe e ëma e pa vetëm kur Bajardo San Romani e mbërtheu për krahu dhe e nxori në dritë. Fustanin prej sateni e kishte të grisur dhe qe mbështjellë deri në mes me një peshqir. Pura Vikarios iu bë se patën thyer qafën me veturë dhe tani preheshin rë vdekur përfund greminës.

- Shënmëri e shenjtë! - tha ajo e lemerisur.

- Flisni, jeni gjallë apo jo?

Bajardo San Romani nuk hyri, vetëm shtyu të shoqen mengadalë brenda, pa folur asnjë fjalë. Pastaj puthi Pura Vikarion në faqe dhe i foli me një zë ku ndihej një hidhërim i thellë, por edhe një dhembshuri e madhe.

- Faleminderit për të gjitha, nënë, - i tha.

- Jeni një shenjtore.

Vetëm Pura Vikarioja e dinte se ç'ndodhi në dy orët e mëpasme dhe këtë të fshehtë e mori me vete në varr. "Mbaj mend vetëm se më kishte mbërthyer nga leshrat me një dorë dhe me tjetrën më godiste aq tërbim, sa thashë se më la në vend", më tregoi Anhela Vikarioja. Por edhe këtë e kishte bërë me aq qetësi, sa as i shoqi e as dy vajzat e mëdha, që flinin në kthinat e tjera, s'pikasën gjë prej gjëje deri ndaj të gdhirë, kur e kishte marrë ferra uratën.

Binjakët u kthyen në shtëpi pak para treshit, të thirrur ngutësisht prej së ëmës. E gjetën Anhela Vikarion të shakullepsur mbi një minder të dhomës së bukës, me fytyrën bërë mavi nga të goditurat, por tashmë

pa lot në sy. "Frika më kishte dalë, - më tregoi ajo. - Ndieja, përkundrazi, sikur më qe hequr prej shpatullave ankthi i vdekjes dhe desha vetëm që gjithçka të mbaronte sa më shpejt, që të shkoja në shtrat e t'ia këpusja gjumit." Pedro Vikarioja, më i krisur ndër dy vëllezërit, e ngriti peshë nga rripi i mezit dhe e uli në tryezë.

- Hajde, çupë e mbarë, i tha duke u dridhur nga tërbimi, - pa më thuaj kush ka qenë?

Ajo pati kohë vetëm sa për të shqiptuar emrin. E kërkoi nëpër terr, e gjeti atë menjëherë mes gjithatyre emrave të panumërt të kësaj e të asaj bote, dhe e la të ngulur në mur me një goditje të përpiktë shigjetareje, ashtu si një flutur, fati i të cilës është i shkruar njëherë e përgjithmonë.

- Santiago Nasari, - tha.

Avokati u mbajt pas tezës së mbrojtjes së ligjshme të nderit, që gjyqi e pranoi, ndërsa binjakët në fund të procesit gjyqësor shpallën se për të njëjtat arsye ata ishin gati të bënin edhe njëmijë herë atë që kishin bërë. Tyreve vetë u shkoi ndër mend të parëve që ta përdornin këtë shkak për t'u mbrojtur, qysh kur shkuan e u dorëzuan në kishë disa minuta pas kryerjes së krimit. Teptisën në famulli duke dihatur, të ndjekur hap pas hapi prej një grupi arabësh të përndezur dhe lanë thikat me tehe të fshira në tryezën e at Amadorit. Të dy qenë krejt të këputur e të dërrmuar nga ai veprim barbar që u quakësh vrasje. Fytyrat i kishin ujë në djersë, në rroba e ndër duar djersa u përzihej me njollat e gjakut ende të patharë, por famullitari e quajti këtë dorëzim një veprim siç u kish hije burrave.

- E vramë me paramendim, - tha Pedro Vikarioja. - Por jemi të pafajshëm.

- Para perëndisë, ndoshta, - tha at Amadori.

- Para perëndisë dhe para njerëzisë, - ia ktheu Pablo Vikarioja. - Ishte çështje nderi.

Për më tepër, në rindërtimin e fakteve u treguan edhe më të breshtë e më të egër nga ç'patën qenë në të vërtetë, aq sa u pa e nevojshme të përdoreshin fonde nga arka e shtetit për të meremetuar portën kryesore të shtëpisë së Plasida Lineros që ishte bërë shoshë nga të goditurat me thika. Në burgun e Rioaçës, ku i mbyllën paraprakisht dhe ndenjën tri vjet në pritje të gjyqit, mbasi nuk kishin me se të paguanin lirimin me kusht, të arrestuarit më të vjetër i kujtonin për qëndrimin e tyre të mirë dhe për shpirtin vëllazror, por s'u kujtohej të kishin vënë re tek ata ndonjë shenjë pendimi. Megjithëkëtë, faktet tregonin se vëllezërit Vikario s'bënë asgjë nga gjithë ç'duhej të bënin për ta vrarë Santiago Nasarin në çast dhe pa bujë. Përkundrazi, patën bërë çmos që dikush t'ua ndalte dorën.

Siç më thanë vite më vonë, ia kishin filluar duke e kërkuar në shtëpinë e Maria Alehandrina Servantesit, ku patën qenë me të deri në orën dy. Kjo hollësi, së toku me shumë të tjera, nuk u regjistrua në procesverbal. Në të vërtetë, Santiago Nasari nuk ndodhej aty në atë orë kur binjakët thonë se vajtën ta kërkonin, mbasi kishim dalë të gjithë bashkë për të bërë një dorë serenada, por, sidoqoftë, nuk ishte e sigurt në e kishin kërkuar aty apo jo. "Assesi nuk do të kishin ikur natën prej meje", më tha Maria Alehandrina Servantesi dhe, siç e njihja aq mirë, kurrë nuk i kisha vënë në dyshim fjalët e saj. Nga ana tjetër, venë vërtet dhe e presin te dyqani i Klotilde Armentës, nga e dinin që mund të kalonte edhe dreqi me të birin, veç Santiago Nasari jo. "Ishte i vetmi dyqan i hapur", - thanë përpara hetuesit. "Herët a vonë kishte për të kaluar që kishte për të kaluar andej", më thanë mua pasi qenë liruar. Të gjithë e dinin se porta kryesore e shtëpisë së Plasida Lineros qëndronte mbyllur me lloz përbrenda, madje edhe gjatë ditës, dhe se Santiago Nasari mbante gjithmonë me vete çelësat e derës së pasme. Dhe, në të

vërtetë, prej andej hyri kur u kthye në shtëpi, ndërsa binjakët Vikario kishin më tepër se një orë që e prisnin nga ana tjetër. Në qoftë se më vonë, kur vajti për të pritur ipeshkvin, kishte dalë nga porta e sheshit kjo pat qenë aq e papritur saqë edhe vetë hetuesi nuk e kish shpjeguar dot.

Vdekje më të paralajmëruar se kjo s'ka pasur ndonjëherë. Me të nxjerrë emrin motra, binjakët Vikario kaluan nga tharku ku mbanin veglat për therjen e derrave dhe zgjodhën dy thikat më të mira: një për të therur, dhjetë gisht të gjatë e dy gisht e gjysmë të gjerë, dhe një për të rrjepur, shtatë gisht të gjatë dhe një gisht e gjysmë të gjerë. I mbështollën me një leckë dhe shkuan t'i mprihnin në pazarin e gjësë, ku sapo kishin filluar të hapeshin disa dyqane. Klientët e parë ishin të paktë, por njëzet e dy vetë dëshmuan se kishin dëgjuar ato ç'ka kishin folur, dhe të gjithë kishin pasur pershtypien se binjakët patën folur pikërisht për t'u dëgjuar. Faustino Santosi, një mik i tyre kasap, i pa të hynin në dyqanin e tij më 3.20, kur sapo kishte nxjerrë tezgën me të brendshme, dhe s'e kuptoi përse vinin një ditë të hëne aq herët, për më tepër edhe me kostumet e dasmës prej shajaku të zi. Qe mësuar t'i shihte të premteve, por pakëz më vonë, dhe me përparëset prej lëkure që vishnin kur thernin. "Thashë se do të qenë rrumbullosur aq rëndshëm - më tha Faustino Santosi, sa që kishin ngatërruar jo vetëm orët, por edhe ditët e javës." Ua kujtoi se ishte e hënë.

- Na e trego ti, se nuk e dimë, - ia ktheu pa të keq Pablo Vikarioja. - Erdhëm sa për të mprehur thikat.

I mprehën me qostër, siç bënin gjithmonë: Pedroja duke mbajtur dy thikat e duke i këmbyer te guri, ndërsa Pabloja duke i dhënë dorezës. Ndërkohë bisedonin me kasapët e tjerë për salltanetet e dasmës. Disa qaheshin se, ndonëse qenë shokë pune, nuk e kishin marrë pjesën e tortës që u takonte dhe vëllezërit u premtonin se do t'ua dërgonin më

vonë. Më në fund, pasi i bënë thikat të këndonin mbi gur, Pabloja e afroi të tijën te llamba që të shihte shkëlqirnin e tehut të çeliktë.

- Do të vrasim Santiago Nasarin, - tha.

Por të gjithë i njihnin për njerëz të mirë e të ndershëm, kështu që askush s'ua vuri veshin. "Na u dukën si dërdëllitje pijanecësh", dëshmuan disa kasapë, ashtu si edhe Viktoria Gusmani e shumë të tjerë që i kishin parë më vonë. Kur i pata pyetur njëherë kasapët se mos për shkak të zanatit kanë një prirje për të vrarë edhe njerëz, ata protestuan. "Kur presim gjënë, ne nuk kemi guxim ta shikojmë në sy." Njëri syresh më tha se nuk e hante dot mishin e gjësë që kishte therur. Një tjetër më tregoi se nuk e priste dot një lopë që e kish njohur më parë, aq më pak po t'i kishte pirë edhe qumështin. Unë u solla ndër mend se vëllezërit Vikario prisnin po ata derra që rritnin dhe që i njihnin aq mirë sa, i thërrisnin me emra. "Është e vërtetë, - m'u gjegj njëri, - veç duhet të keni parasysh se nuk u vinin emra njerëzish, po vetëm emra lulesh." Faustino Santosi qe i vetmi që dalloi një grimës të vërtetë në kërcënimin e Pablo Vikarios dhe e pyeti këtë me shaka përse donin ta vrisnin Santiago Nasarin, kur kishte sa e sa pasunarë që e patën bërë hak të vdisnin më parë se ai.

- E di vetë ai përse, - iu gjegj Pedro Vikarioja.

Faustino Santosi më tregoi se një dyshim i pat përbrenda dhe këtë dyshim ia kish shfaqur një polici që pat kaluar pak më vonë për të blerë gjysmë kile për mëngjesin e alkaldit. Polici, sipas procesverbalit, quhej Leandro Pornoi dhe kishte vdekur pas një viti, gjatë festave të vendit, nga një goditje demi në dellin e qafës. Kështu që unë s'munda dot kurrë të bisedoja me të, por Klotilde Armenta më siguroi se polici pat qenë i pari që hyri në dyqanin e saj pasi binjakët Vikario qenë ulur e po prisnin.

Klotilde Armenta sapo kishte zëvendësuar të shoqin në banak. Këtë rregull ndiqnin zakonisht. Dyqani shiste qumësht në mëngjes, ushqime gjatë ditës dhe kthehej në pijetore qysh prej orës gjashtë të mbrëmjes. Klotilde Armenta e hapte pa gdhirë mirë, në 3.30. I shoqi, babaxhani don Rohelio de la Flor, përgjigjej për pijetoren deri në orën e mbylljes. Por asaj nate kishte pasur aq shumë klientë që vinin kokrra-kokrra pas dasmës, sa pijetorja pat mbetur gjer më tre pa mbyllur dhe Klotilde Armenta qe çuar më herët se zakonisht, ngaqë deshte të mbaronte përipara mbërritjes së ipeshkvit.

Vëllezërit Vikario hynë në dyqan më 4.10. Në atë orë shiteshin vetëm qurnësht dhe ushqime, mirëpo Klotilde Armenta u dha një shishe me raki jo vetëm nga respekti që kishte për ta, por edhe sepse kishte mbetur shumë e kënaqur prej racionit të tortës qe i kishin dërguar nga dasma. E kthyen shishen me fund me dy të shklluqura, pa u bërë asnjë përshtypje. "Kishin ngrirë, - më tha Klotilde Armenta, - dhe nuk i nxehte dot as vajguri." Pastaj hoqën xhaketat prej shajaku, i vendosën me shumë kujdes në shpinoret e karrigeve dhe kërkuan një shishe tjetër. Këmishat u qenë bërë këllirë nga djersa e tharë dhe mjekra një ditë pa rruar i bënte të dukeshin si të egër. Shishen e dytë e morën më me nge, të ulur, me sytë të ngulur nga shttëpia e Plasida Lineros që ndodhej kundruall, në dritaret e së cilës nuk kishte ende dritë. Dritarja më e madhe, ajo e ballkonit, ishte dritarja e dhomës së Santiago Nasarit. Pedro Vikarioja e pyeti Klotilde Armentën nëse kish parë gjë dritë në atë dritare. Ajo iu përgjigj që jo, por pyetja i ngjalli kureshtjen.

- Pse, ç'i ka bërë vaki? - pyeti.

- Asgjë, - iu gjegj Pedro Vikarioja. - Vetëm se po e kërkojmë për ta vrarë.

Qe një përgjigje aq e papritur, saqë ajo nuk u besoi veshëve. Por i bëri përshtypje se binjakët kishin me vete dy thika kasapësh të mbështjella me lecka.

- A mund ta dimë përse dashkeni ta vrisni, bile kaq herët? - i pyeti ajo.

- E di vetë ai përse, - iu gjegj Pedro Vikarioja.

Klotilde Armenta filloi t'i shihte më me vëmendje. I njihte aq mirë sa qe në gjendje edhe t'i dallonte nga njëri-tjetri, sidomos pasi Pedro Vikarioja qe kthyer prej ushtrisë. "Ngjanin si dy kalamaj", më tha. Dhe ky mendim i vet e trembi, se gjithmonë pat menduar që vetëm kalamajtë janë në gjendje të bëjnë atë që s'ta pret mendja. Kështu që, me të mbaruar punë me shishet e qumështit, vajti të zgjonte të shoqin për t'i treguar se ç'po ndodhte në dyqan. Don Rohelio de la Flori e dëgjoi përgjumësh.

- Budallaqe që bëhesh, - i tha. - S'vrasin njeri ata kalamaj, aq më tepër një pasunar.

Kur Klotilde Armenta u kthye në dyqan, binjakët po bisedonin me policin Leandro Pornoi, që kishte ardhur të merrte qumështin për alkaldin. Nuk dëgjoi së folur, por nga mënyra se si i vështroi polici thikat tek dilte, e mori me mend se ata ia kishin treguar planin.

Kolonel Lasaro Aponteja qe ngritur pak përpara orës katër. Sapo kishte mbaruar së rruari, kur polici Leandro Pornoi i tregoi se ç'kishin ndër mend të bënin vëllezërit Vikario. Kishte zgjidhur aq zënka midis miqsh një natë më parë, saqë nuk u ngut aspak të zgjidhte edhe një tjetër. U vesh qetësisht, u mundua disa herë derisa e rregulloi për merak kravatën flutur dhe vari në qafë medaljonin e kongregacionit të Shën Mërisë për të dalë në pritje të ipeshkvit. Ndërkohë që hante për mëngjes një pjatë mëlçiçkash të zbukuruar me rrotulla qepësh, e shoqja i rrëfeu

shumë e tronditur se Bajardo San Romani e kishte kthyer Anhela Vikarion, por koloneli s'u trondit kushedi se çfarë nga ky lajm.

- O zot i madh, - u tall, - kushedi ç'do të mendojë ipeshkvi!

Mirëpo, pa mbaruar ende së ngrëni, solli ndër mend se ç'i kish thënë aty më parë polici i tij, i bashkoi të dy lajmet dhe vuri re se puqeshin me njëri-tjetrin si dy pjesë të një rebusi. Atëherë u nis për te sheshi nëpër rrugën e portit të ri, shtëpitë e së cilës po gjallëroheshin për pritjen e ipeshkvit. "Mbaj mend mirë se ishte pothuaj ora pesë dhe zuri të binte shi", më tha kolonel Lasaro Aponteja. Në udhë e sipër tre vetë e ndalën për t'i pëshpëritur në vesh se vëllezërit Vikario po prisnin Santiago Nasarin për ta vrarë, por vetëm njëri syresh diti t'i thoshte se ku.

I gjeti në dycianin e Klotilde Armentës. "Kur i pashë, mendova se dërdëllitnin kot, më tha ai me logjikën e vet, se s'qenë aq të dehur sa pandehja." As që i pyeti se ç'kishin ndër mend të bënin, por ua hoqi thikat dhe i nisi të flinin. U soll me ta po aq urtë e butë sa ç'qe sjellë edhe me të shoqen kur kjo i kish dhënë lajmin e alarmuar.

- Pa mendoni pak, u tha, - se ç'do të thotë ipeshkvi po t'ju shohë në këtë katandi!

Vëllezërit kishin shkuar. Klotilde Armenta pësoi edhe një zhgënjim tjetër me këtë moskokëçarje të alkaldit, ngaqë kishte menduar se ai duhej t'i arrestonte binjakët derisa të sqarohej puna. Kolonel Aponteja i tregoi thikat si një argument përfundimtar.

- Tani nuk kanë me se të vrasin askënd, - i tha.

- S'është halli aty, - i tha Klotilde Armenta. - Duhen shpëtuar ata djem të gjorë nga ai mendim i tmerrshëm që u ka shkrepur në kokë.

Ajo diç kishte nuhatur dhe ishte e sigurt që vëllezërit Vikario nuk qenë dhe aq të dëshiruar ta shpinin në vend vendimin që kishin

marr, sesa të gjenin një njeri që t'ua ndalte dorën. Por kolonel Aponteja ishte në rregull me ndërgjegjen e vet.

- S'arrestohet tjetri vetëm për një dyshim, - tha. - Tani puna është të paralajmërohet Santiago Nasari dhe tungjatjeta!

Klotilde Armenta do ta kujtonte gjithmonë ndjesinë e ligë që i ndillte ajo pamja shulake e kolonel Apontes, ndërsa unë e sillja atë ndër mend si një njeri të lumtur, ndonëse pakëz të budallallepsur nga spiritizmi që e kish mësuar nëpërmjet postës dhe e ushtronte në vetmi. Sjellja e asaj provë më se e qartë e mendjelehtësisë së tij. Fakti është se atij as që i ra ndër mend për Santiago Nasarin deri në çastin kur e pa atë në port dhe atëherë i bëri qejfin vetes duke e quajtur plotësisht të mjaftueshme masën që kishte marrë.

Vëllezërit Vikario ua kishin treguar planin e tyre më shumë se dymbëdhjetë vetëve që patën shkuar për të blerë qumësht dhe këta e kishin përhapur anembanë përpara orës gjashtë. Klotilde Armentës i dukej e pamundur që në shtëpinë kundruall të mos e kishin marrë vesh. I thoshte mendja se Santiago Nasari s'duhej të qe aty, mbasi nuk kishte parë të ndizej dritë në dhomën e tij të gjumit dhe kujtdo që mundte i lutej ta paralajmëronte po ta takonte. I dërgoi fjalë bile edhe at Amadorit me shërbëtoren që erdhi të blinte qumësht për murgeshat. Pas orës katër, kur pa dritë në kuzhinën e shtëpisë së Plasida Lineros, i dërgoi urgjent njoftimin e fundit Viktoria Gusmanit me lypsaren që kalonte përditë për të kërkuar pakëz qumësht. Kur u dëgjua uturima e anijes së ipeshkvit, pothuajse të gjithë ishin çuar dhe qenë bërë gati ta prisnin, dhe qemë shumë pak ne që nuk e dinim se vëllezërit Vikario po e prisnin Santiago Nasarin për ta vrarë, Madje të tjerët dinin edhe shkakun dhe të gjitha hollësitë.

Klotilde Armenta s'kishte mbaruar së shituri qumështin, kur vëllezërit Vikario erdhën përsëri me dy thika të tjera të mbështjella me gazeta. Njëra ishte për të therur, me një teh të ndryshkur e të çatallosur, dymbëdhjetë gisht e gjatë dhe tre e gjerë, e bërë vetë nga Pedro Vikarioja me materialin e një sharre qysh në kohën kur në Pazar nuk shiteshin thika gjermane për shkak të luftës. Tjetra qe më e shkurtër, por e gjerë dhe e kthyer. Hetuesi e kishte vizatuar në proçesverbal, ndoshta ngaqë nuk kishte mundur ta përshkruante, dhe vetëm kishte kuturisur të vrente se dukej si një jatagan në miniaturë. Pikërisht me këto thika primitive u krye krimi.

Faustinoja s'e kishte kuptuar dot se ç'po ndodhte. "Erdhën t'i mprihnin edhe një herë thikat, - më tha, - dhe zunë të thërrisnin përsëri se do t'ia nxirrnin zorrët Santiago Nasarit, kështu që unë pandeha se po shisnin mend kot, aq më tepër ngaqë nuk i pashë më thikat dhe mendova se genë po ato." Megjithëkëtë, Klotilde Armenta kësaj radhe vuri re kur hynë se nuk qenë të vendosur si në fillim.

Ç'është e vërteta, midis vëllezërve kishte lindur mosmarrëveshja e parë. Ata jo vetëm që ndryshonin shumë nga ana shpirtërore, në krahasim me ç'ngjanin nga ana fizike, por në çaste vështirësish të papritura kishin karaktere të kundërta. Shokët e tyre e patën vënë re këtë gjë qysh në shkollën fillore. Pablo Vikarioja qe gjashtë minuta më i madh se i vëllai dhe pat qenë dalluar për imagjinatë e vendosmëri deri në prag të rinisë. Pedro Vikarioja m'u pat dukur gjithmonë më i ndjeshëm, prandaj edhe më i pushtetshëm. U paraqitën të dy për të bërë ushtrinë në moshën 20-vjeçare, por Pablo Vikarion e liruan që të qëndronte në krye të familjes. Pedro Vikarioja bëri dymbëdhjetë muaj ushtri në patrullat e rendit publik. Disiplina ushtarake, së cilës i shtohej edhe frika e vdekjes, ia theksoi edhe më prirjen për të urdhëruar dhe zakonin për të vendosur edhe në emër të të vëllait. U kthye në shtëpi me

një "frëngjyzë rreshterësh", që s'kishte dashur t'ia dinte as nga metodat më të egra të mjekësisë ushtarake, as nga injeksionet me arsenik dhe spastrimet me permaganat të doktor Dionisio Iguaranit. Vetëm në burg iu gjet dermani. Ne miqtë e tyre qemë të gjithë të një mendimi se Pablo Vikarioja pat treguar menjëherë një varësi të rrallë prej vëllai më të vogël, kur Pedro Vikarioja qe kthyer prej ushtrie me zakonet e kazermës dhe me një vrajë plumbi në ijën e majtë, të cilën ia tregonte gjithkujt duke ngritur këmishën. Pablo Vikarioja filloi të ndiente madje edhe një lloj ashku ndaj asaj frëngjyzës prej burri të madh me të cilën i vëllai mburrej si me rijë dekoratë lufte.

Siç kishte deklaruar vetë, Pedro Vikarioja pat qenë ai që kishte marrë vendimin për të vrarë Santiago Nasanna dhe i vëllai, në fillirn, vetëm sa e pat ndjekur. Pat qenë përsëri ai që e kishte quajtur detyrën të përmbushur, kur i kishte çarmatosur alkaldi, dhe atëherë e kishte marrë Pablo Vikarioja komandën. Asnjëri syresh nuk e pat zënë ngoje këtë mosmarrëveshje në deponimet e veçanta që bënë përpara hetuesit. Mirëpo Pablo Vikarioja më tregoi më se një herë që nuk e kishte pasur të lehtë ta bindte të vëllanë për ta shpënë në vend vendimin e marrë. Mbase ky s'kishte qenë veçse një çast frikësimi, por fakti është që Pablo Vikarioja hyri i vetëm në tharkun e derrave për të kërkuar dy thika të tjera, ndërsa i vëllai po hiqte pikën e zezë rrëzë një *tamarindi*, duke u përpjekur të derdhte ujët pikë-pikë .Im vëlla s'e ka provuar ndonjëherë atë çka hoqa unë, - më tha.

- Dhe u përpoq të më bindte që të shkoja vetë, se ai s'qe në gjendje të vriste askënd". Zuri vend në një nga tryezat e sajuara për drekën e dasmës dhe uli pantallonat deri në gjunjë. "U vonua ndonjë gjysmë ore duke ndërruar garzat", më tha Pablo Vikarioja. Në të vërtetë, s'ishte vonuar më shumë se dhjetë minuta, por pat qenë një punë aq e

vështirë për pudro Vikarion dhe aq e pakuptueshme për Pablo Vikarion, sa këtij të fundit i qe dukur si një dredhi e re e të vëllait për të fituar kohë derisa të gdhihej. Prandaj i vuri thikën në dorë dhe e ngriti pothuajse me zor për të vënë në vend nderin e motrës.

- Rrugë tjetër s'ka, - i tha. - Zëre se e kemi vrarë tashmë.

Dolën me thikat të pambështjella, ndjekur nga të lehurat e qenve nëpër oborre. Po zbardhte. "Shi nuk binte, - kujtonte Pablo Vikarioja. Përkundrazi, - kujtonte Pedroja, - frynte erë deti dhe yjet ende nuk mund t'i numëroje me gisht." Lajmi në atë kohë pat marrë dhenë, kështu që Hortensia Baute hapi portën e saj mu në çastin kur ata po i kalonin përpara shtëpisë dhe qe e para që e qau Santiago Nasarin. "Thashë se do ta kishin vrarë, - më tha, - mbasi pashë thikat në dritë të fenerit dhe m'u dukën sikur kullonin gjak". Një nga shtëpitë e pakta që ndodheshin në atë rrugë të humbur ishte edhe ajo e Prudensia Kortesit, të fejuarës së Pablo Vikarios. Sa herë që binjakët kalonin andej në atë orë, sidomos të premteve kur shkonin për në Pazar, hynin për të pirë kafenë e parë. Shtynë derën e oborrit, zmbrapsën qentë, që më në fund njohën në mugun e agimit dhe përshëndetën nënën e Prudensia Kortesit në kuzhinë. Kafeja s'qe ende gati.

- E pimë rnë vonë, - tha Pablo Vikarioja.

- Tani s'na pret puna.

- Ashtu është, bijtë e nënës, tha ajo, nderi nuk pret. Megjithëkëtë, ata pritën dhe atëherë qe Pedro Vikarioja ai që pandehu se i vëllai desh të vonohej me kast. Ndërsa pinin kafenë, hyri në kuzhinë Prudensia Kortesi, në lule të rinisë, me një tufë gazetash të vjetra për të shpurritur zjarrin në oxhak. "E dija ç'kishin ndër mend të bënin, më tha, - dhe jo vetëm që isha dakord, por kurrë s'do të isha martuar me Pablon sikur ai të mos e kishte kryer detyrën si burrë". Para se të dilte nga kuzhina, Pablo Vikarioja i mori disa fletë gazete dhe i

zgjati edhe që të mbështillnin thikat. Prudensia Kortesi ndenji e priti në kuzhinë, derisa i pa të dilnin nga porta e oborrit dhe vazhdoi të priste edhe për tre vjet, pa e bjerrur shpresën kurrë, derisa Pablo Vikarioja doli nga burgu dhe u bë burri i saj në të mira e në të liga.

- Hapni sytë, - u thirri ajo.

Kështu që Klotilde Armenta s'ishte gabuar kur i qe dukur se binjakët nuk qenë aq të vendosur sa më parë. Ajo u dha një shishe me vodkë kontrabande me shpresë që t'i trushullepste. "Atë ditë e kuptova, - më tha ajo, se sa të vetmuara jemi ne gratë në botë!" Pedro Vikarioja i lypi hua veglat e rrojës së të shoqit dhe ajo i pruri furçën, sapunin, pasqyrën varëse dhe makinën me brisk të ri, por ai u rruajt me biçakun e xhepit. Për Klotilde Armentën ky qe kulmi i demonstrimit të forcës mashkullore. "Dukej si ata xhagajdurët e filmave", më tha ajo. Siç më shpjegoi vetë më vonë Pedro Vikarioja, në ushtri qe mësuar të rruhej me brisk berberi dhe qysh atëherë nuk qe rruajtur dot më tjetërsoj. I vëllai, nga ana e tij, u rruajt në mënyrë më të përvuajtur, me makinën e marrë hua don Rohelio de la Florit. Pastaj pinë shishen në heshtje, pa u ngutur aspak, duke bërë sehir, me pamjen e topitur të njerëzve që s'kanë vënë gjumë në sy, dritaren e errët të shtëpisë kundruall. Ndërkohë në dyqan hynin e dilnin klientë të shtirur, gjoja për të blerë qumësht dhe pyesnins për ushqime që s'i kish dyqani, verëm për të parë nëse qe e vërtetë që binjakët po prisni Santiago Nasarin për ta vrarë.

Vëllezërit Vikario s'po shihnin që s'po shihnin dritë në atë dritare. Santiago Nasari qe kthyer në shtëpi më 4.20, por nuk kishte ndezur asnjë dritë për të vajtur në dhomën e gjumit, sepse feneri i shkallës qëndronte ndezur gjithë natës. Kish rënë në shtrat në të errët dhe pa u zhveshur, se vetëm një orë i mbetej për të fjetur, dhe ashtu e pat gjetur Vikrori Gusmani kur qe ngritur ta zgjonte për të vajtur në

pritje të ipeshkvit. Kishin qenë së bashku në shtëpinë e Maria Alehandrina Servantesit deri pas treshit, kur ajo vetë i përzuri sazexhinjtë dhe fiku dritat e sheshit të vallëzimit, në mënyrë që mulatet e shtëpisë së saj të dëfrimit të binin për t'u çlodhur vetëm, pa klientë. Kishin tri ditë e tri netë që punonin pa pushim, në krye duke pritur në fshehtësi mysafirët e nderit, pastaj me dyert kanat për të gjithë ata që, si puna jonë, kishin mbetur te pullë në zdërhalljen e dasmës. Maria Alehandrina Servantesi, për të cilën ne thoshim se kish për të fjetur vetëm kur të vdiste, qe gruaja më e hijshme e më e dhembshur nga të gjitha gratë që kam njohur, më e këndshmja në shtrat, por edhe më e rrepta. Qe lindur e rritur këtu dhe banonte po këtu në një shtëpi me porta të hapura, me kthina që jepeshin me qira dhe me një oborr që shërbente si shesh vallëzimi, rreth e gark me drita të futura brenda abazhurësh në formë kungujsh, të blerë në pazaret e Paramarivos. Ajo ia prishi virgjërinë krejt brezit tim. Na mësoi ndoshta edhe më tepër nga ç'duhej, por na mësoi sidomos se s'ka gjë më të trishtë në botë sesa shtrati i zbrazët. Santiago Nasari luajti mendsh pas saj qysh kur e pa për së pari. Unë e pata lajmëruar: "Po e ngacmove grerëzën, prit edhe thumbin". Por ai s'ma kish vënë veshin, i trullosur siç qe prej gugatjeve magjepsëse të Maria Alehandrina Servantesit. Ajo pat qenë harbimi i tij i parë, shkaku i lotëve të tij qysh në moshën 15-vjeçare, derisa një ditë prej ditësh Ibrahim Nasari e pat nxjerrë me shkelma nga shtrati i saj dhe e pat mbyllur për më tepër se një vit në *hasiendën* "Divino Rostro". Qysh atëherë mbetën të lidhur me një dashuri të thellë, jo më të çmendur e të rrëmujshme, dhe ajo e respektonte aq shumë saqë nuk binte në shtrat me tjetërkënd, po të kish Santiago Nasarin pranë. Në pushimet e mia të fundit ajo na kurdiste herët, gjoja se qe e lodhur, pastaj linte derën pa mandall dhe një dritë të ndezur në treme, që unë të vija e të hyja përsëri tinës.

Santiago Nasari kishte një talent pothuajse prej magjistari për të ndryshuar veshjet dhe qejfi i tij ishte t'ua ndërronte ato mulateve. Zbraste gardërobat e disave për të veshur të tjerat, aq sa këto tekefundit e ndienin veten të ndryshme nga ç'ishin dhe të ngjashme me ato që s'ishin. Njëherë njërës prej mulateve iu duk vetja aq e ngjashme me tjetrën, saqë u shkreh në të qara. "M'u duk sikur kisha dalë nga pasqyra", tha. Porse atë natë Maria Alehandrina Servantesi nuk e lejoi Santiago Nasarin të ushtronte për të fundit herë mjeshtrinë e tij të dashur të ndërrimit të veshjeve. Dhe e bëri këtë për shkaqe aq pa rëndësi, saqë vetëm kujtimi i hidhur i këtij veprimi ia nxiu jetën. Kështu që ne morëm sazexhinjtë dhe vazhduam festën për hesapin tonë, duke bërë serenada, ndërsa vëllezërit Vikario e prisnin Santiago Nasarin për ta të ngjiteshim majë kodrës te vila e vejanit Ksius për t'u bërë një serenadë mëngjesi të sapomartuarve.

U kënduam poshtë dritareve, madje hodhëm edhe fishekzjarre në kopsht, por nga vila nuk ndiem shenjë jete. S'na e mori mendja të mos kishte njeri, aq më tepër ngaqë vetura ishte te porta, ende me mbulesën e ngritur dhe me shiritat prej mëndafshi e luleportokallet prej parafine që kishin hedhur gjatë festës. Im vëlla Luis Enrike, që i binte kitarës si profesionist, improvizoi për të sapomartuarit një këngë me ngatërresa bashkëshortore. Deri në atë kohë nuk kishte rënë shi. Përkundrazi, hëna shndriste mu në mes të qiellit, ajri ishte i tejdukshëm dhe në fund të r.rpirës dalloheshin llapëtimat e zjarreve të vetvetishme të varrezës. Nga ana tjetër shquheshin plantacionet me banane, të kaltra nën dritën e hënës, moçalishtet e pikëlluara dhe vija fosforeshente e detit të Karaibeve në synor. Santiago Nasari na tregoi një dritë vezulluese në det dhe na tha se ishte shpirti i pastrehë i një anijeje tregtare skllevërish nga Senegali, të mbytur në të hyrë të portit në

Kartahena de Indias. Assesi s'kish pse të mendoje se e shqetësonte gjësend në ndërgjegje, le që atëherë ai ende nuk e dinte se jeta e shkurtër bashkëshortore e Anhela Vikarios kishte marrë fund para dy orësh. Bajardo San Romani e kishte shpënë në këmbë në shtëpinë e prindërve, në mënyrë që zhurma e motorit të mos e përhapte fatkeqësinë e saj para kohe, dhe qe kthyer përsëri e rrinte me dritat fikur në vilën e madhe e të lumtur të vejanit Ksius.

Kur zbritëm nga kodra, im vëlla na ftoi të hanim për mëngjes peshk të fërguar në dyqanet e pazarit, por Santiago Nasari s'pranoi, mbasi deshte të flinte një orë derisa të vinte ipeshkvi. Iku me Kristo Bedojën gjatë bregut të lumit, duke u rënë qark kasolleve të të varfërve në portin e vjetër, në të cilat kishin filluar të ndizeshin dritat dhe, para se të merrte kthesën, na e bëri me dorë. Ishte hera e fundit që e shihnim.

E lanë me Kristo Bedojën të takoheshin në port dhe u ndanë te dera e pasme e shtëpisë. Qentë, si zakonisht, cafulluan kur hyri, por ai i qetësoi nëpër gjysmëerrësirë duke tringëllitur çelësat. Viktoria Gusmani po përgjonte xhezven e kafesë te zjarri, kur ai kaloi nëpër kuzhinë për t'u futur në shtëpi.

- Ej, burravec, - i thirri ajo. - T'u bë kafeja.

Santiago Nasari i tha se do ta pinte më vonë dhe e porositi t'i thoshte Divina Florit që ta zgjonte në pesë e gjysmë e t'i sillte një palë rroba të pastra njëlloj si ato që pat veshur. Një grimë pasi ai u ngjit për të fjetur, Viktoria Gusmani mori lajmërimin e Klotilde Armentës me lypësen e qumështit. Në 5.30 zbatoi urdhrin që ta zgjonte, veçse nuk dërgoi Divina Florin, por u ngjit ajo vetë në dhomën e gjumit me kostumin veror prej linoje, mbasi orë e çast kujdesej ta ruante të bijën nga thonjtë e padronit.

Maria Alehandrina Servantesi nuk i kishte hedhur llozin portës së shtëpisë. Unë u ndava nga im përshkova tremen ku maçokët e

mulateve flinin të tulatur midis tulipanëve dhe hyra pa trokitur në dhomën e gjumit. Dritat qenë fikur, por me të hyrë ndjeva erën e gruas së ngrohtë, shqova nëpër të errët xixëllimën e syve prej pantere të pagjumë, pastaj nuk mbajta mend gjë prej gjëje derisa filluan të binin kambanat.

Gjatë rrugës për në shtëpi, im vëlla hyri për të blerë cigare në dyqanin e Klotilde Armentës. Aq i pirë kishte qenë, saqë kujtimet e tij për këtë takim qenë gjithmonë fort të pështjelluara, por ama nuk e harroi kurrë atë kupë vdekjeprurëse që piu prej Pablo Vikarios. "S'qe pije, por eksploziv", më tha. Pablo Vikarioja, që kishte filluar të dremiste, u hodh përpjetë kur e dëgjoi të hynte dhe i tregoi thikën.

- Do të vrasim Santiago Nasarin, - i tha.

Im vëlla këtë nuk e mbante mend. "Po edhe sikur ta mbaja mend, nuk do ta kisha besuar, - më tha shpeshherë. - Kujt dreqin mund t'ia merrte mendja se binjakët do të vrisnin ndokënd, aq më tepër me një thikë derrash!" Pastaj e kishin pyetur se ku qe Santiago Nasari, mbasi i kishin parë së bashku në orën dy, dhe tim vëllai përsëri nuk i kujtohej se ç'përgjigje u pat dhënë. Por Klotilde Armenta dhe vëllezërit Vikario qenë habitur aq shumë kur kishin dëgjuar përgjigjen e tij, saqë çdonjëri veç e veç e kishin vënë në dukje gjatë deponimeve dhe ajo qe futur në procesverbal. Sipas tyre, im vëlla u paskësh thënë: "Santiago Nasari ka vdekur". Pastaj u kish dhënë të gjithëve një bekim episkopal, kish përpjekur kokën pas shtalkës së derës dhe kish dalë përjashta marrakëmbthi. Në mes të sheshit qe ndeshur me at Amadorin, që shkonte për në port veshur me petkat e meshës, i pasur nga një çun i korit që i binte zilkës dhe nga disa xhakonë me lterin për meshën fushore të ipeshkvit. Tek i kishin parë të kalonin, vëllezërit Vikario kishin bërë kryq.

Klotilde Armenta më tregoi se, kur famullitari kishte kaluar para dyqanit të saj, vëllezërit i kishin humbur edhe shpresat e fundit. "Unë thashë se at Amadori s'do ta kishte marrë lajmërimin tim", më tregoi ajo. Megjithëkëtë at Amadori, pas shumë vitesh, i tërhequr nga bota në të errtën "Shtëpi të Shëndetit" në Kalafell, më tregoi se në të vërtetë e kishte marrë lajmërimin e Klotilde Armentës, si dhe plot lajmërime të tjera shqetësuese, teksa përgatitej të shkonte në port. "Ç'është e vërteta, nuk dija ç'të bëja, - më tha. - Thashë një herë me mend se kjo s'cle puna ime, por e autoriteteve civile. Më pas vendosa t'i hidhja një fjalë Plasida Lineros". Sidoqoftë, kur kapërceu sheshin, i kishte dalë nga mendja fare. "Duhet të më kuptoni, - më tha, - se atë ditë mynxyre vinte ipeshkvi". Kur qe kryer krimi, ai e pat ndier veten aq të dëshpëruar dhe aq të padenjë, saqë s'i pat ardhur gjë tjetër në kokë veçse të urdhëronte t'u binin kambanave si për zjarr.

Im vëlla Luis Enrike hyri në shtëpi nga dera e kuzhinës, të cilën ime ëmë e linte pa mandall që të mos na pikaste babai kur hynim. U fut në banjë para se të binte për të fjetur, por e zuri gjumi mbi qenef dhe, kur im vëlla Haimeja u ngrit për të vajtur në shkollë, e gjeti të shakullepsur mbi çimento e duke kënduar nëpër gjumë. Ime motër murgesha, që nuk do të shkonte për të pritur ipeshkvin, se kishte një dhembje koke me temperaturë dyzet, nuk e zgjoi dot. "Po binte ora pesë kur shkova në banjë", më tha ajo. Më vonë, kur ime motër Margoti hyri të lahej para se të nisej për në port, bëri si bëri dhe mundi ta ngrinte me zor e ta shpinte në dhomë të gjumit. Pa i dalë gjumi, ai dëgjoi si nëpër ëndërr uturimat e para të anijes së ipeshkvit. Pastaj e zuri një gjumë i rëndë, që i doli vetëm kur ime motër murgesha hyri në dhomë duke u përpjekur të vishte petkun me ngut dhe e zgjoi me klithmën e saj prej të marre:

- Vranë Santiago Nasarin!

***

Gjymtitë e shkaktuara prej thikave patën qenë vetëm fillimi i autopsisë së pamëshirshme që u detyrua të bënte at Karmen Amadori në mungesë të doktor Dionisio Iguaranit. "Sikur po e vrisnim edhe një herë pas vdekjes, më tha ish-famullitari në vendtërheqjen e tij në Kalafell. - Por qe urdhër i alkaldit dhe urdhrat e atij mizori, sado të marra që të ishin, duheshin zbatuar". Nuk qe plotësisht kështu. Në pështjellimin e asaj të hëne të nëmur, kolonel Aponteja kishte pasur një bisedim telegrafik urgjent me guvernatorin e krahinës dhe ky e kishte urdhëruar të merrte masa paraprake derisa të dërgonin një hetues. Alkaldi pat qenë dikur oficer trupash dhe s'kishte përvojë në çështjet e dreitoisë. Nga ana tjetër, nuk mund të ulte hundën e të pyeste ndokënd se nga duhej filluar. Gjëja e parë që zuri ta shqetësonte ishte autopsia. U pranua të merrej me këtë punë Kristo Bedoja, që vazhdonte studimet për mjekësi, meqë pat qenë shok i ngushtë me Santiago Nasarin. Alkaldi mendoi se trupi mund të mbahej i ngrirë derisa të vinte doktor Dionisio Iguarani, por nuk gjeti dot frigorifer në bojë të njeriut. Edhe një i vetëm që gjeti në Pazar, ishte i prishur. Trupi qe vendosur për t'u parë nga të gjithë në mes të sallonit, i shtrirë mbi një krevat të ngushtë prej hekuri, ndërkohë që po i përgatisnin një qivur siç i kish hije. Nga dhomat e gjumit dhe nga disa shtëpi fqinje kishin prurë ventilatorët, por kishte aq shumë njerëz që donin ta shikonin, sa që u desh të hiqeshin mobiliet, kazazët me zogj, poçet me fier dhe megjithëkëtë zagushia qe e padurueshme. Veç kësaj, qentë e ndezur nga era e vdekjes e shtonin rrëmujën. S'kishin pushuar së angullituri qyshse pata hyrë unë në shtëpi, kur Santiago

Nasari po jepte shpirt në kuzhinë dhe Divina Florin e gjeta tek kishte vënë kujën dhe largonte qentë me hu.

- Ndihmomë, - më tha - se duan t'i hanë zorrët.

I mbyllën në grazhd. Më vonë Plasida Lineroja dha urdhër t'i shpinin diku më larg derisa të bëhej varrimi. Por aty nga dreka nuk u mor vesh se si patën shpëtuar dhe teptisën si të tërbuar në shtëpi. Plasida Lineroja kësaj radhe nuk e mbajti dot më veten.

- Qentë e mutit, - thirri, - vritini!

Urdhri u zbatua menjëherë dhe shtëpia u krodh sërish në heshtje. Gjer më atëherë askush nuk qe shqetësuar për gjendjen e trupit. Fytyra kishte mbetur e paprekur, me atë shprehje që kishte Santiago Nasari kur ia merrte këngës dhe Kristo Bedoja ia kishte futur rropullitë në vend dhe e kishte lidhur me një fashë linoje. Mirëpo ndaj të ngrysur filluan të rridhnin prej plagëve ca lëngje me ngjyrë shurupi, që tërhoqën mizat, një njollë mavi iu shfaq rreth gojës dhe, si hija e një reje mbi ujë, filloi të përhapej me të shpejtë deri në rrënjë të flokëve. Shprehja e fytyrës ngaherë dashamirëse, iu shndërrua në armiqësore dhe e ëma ia mbuloi fytyrën me shami. Kolonel Aponteja e kuptoi atëherë se nuk mund të pritej më dhe i dha urdhër at Amadorit të bënte autopsinë. "Më keq do të jetë po ta zhvarrosim pas një jave", tha. Famullitari kishte studiuar mjekësi dhe kirurgji në Salamank, por kishte kaluar në seminarin fetar pa mbrojtur diplomën, kështu që edhe vetë alkaldi e dinte se autopsia e tij nuk kishte vlerë ligjore, Megjithëkëtë, kërkoi të zbatohej urdhri.

Qe një kasaphanë, që u bë në ndërtesën e shkollës me ndihmën e spicerit që mbajti shënime dhe të një studenti të vitit të parë të mjeksisë që ndodhej aty për pushime. Kishin në dorë vetëm disa vegla që përdoren në kirurgjinë e vogël, ndërsa të tjerat qenë hekurishte zanatçinjsh. Mirëpo, po të mos llogarisim gjymtitë e reja që iu bënë

trupit, raporti i at Amadorit qe i rregullt dhe hetuesi e futi atë në procesverbal si dokument me vlerë.

Nga plagët e shumta, shtatë kishin qenë vdekjeprurëse. Mëlçia e zezë qe copëtuar thuajse krejtësisht nga dy shpime të thella në pjesën ballore. Në stomak kishte gjithashtu katër shpime, njëri prej të cilëve aq i thellë, sa e kishte përshkuar tejetej dhe kishte shkatërruar edhe pankreasin. Kishte gjashtë shpime të tjera më të vogla në zorrën e trashë gjerësore si dhe plagë të shumta në zorrët e holla. Goditja e vetme në shpinë, në lartësinë e rruazës së tretë të belit, i kishte shpuar veshkën e djathtë. Zgavra e barkut qe mbushur me një sasi të madhe droçkash gjaku dhe midis lëngut të trashë të stomakut u shfaq një medaljon floriri i Virgjëreshës së Karmenit, që Santiago Nasari e kishte kapërdirë në moshën katërvjeçare. Edhe kafazi i kraharorit kishte dy shpime: njëri në hapësirën e dytë midis brinjëve të djathta, që kish arritur deri në mushkëri, dhe tjetri shumë pranë sqetullës së majtë. Kishte edhe gjashtë plagë më të lehta në krahë e në duar, si dhe dy të prera horizontale: një në kofshën e djathtë dhe një në muskujt e barkut. Në pëllëmbën e dorës së djathtë kishte një të shpuar të thellë. "Dukej si një stigmë e Krishtit të kryqëzuar", thuhej në raport. Lënda trurore peshonte gjashtëdhjetë gram më tepër nga ajo e një anglezi normal dhe at Amadori kishte shënuar në raport se Santiago Nasari paskësh pasur një aftësi intelektuale të veçantë dhe një të ardhme të ndritur. Në paragrafin e fundit at Amadori shënonte një hipertrofi të mëlçisë së zezë dhe ia ngjiste këtë një hepatiti të pashëruar mirë. "Kështu që, sidoqoftë, - më tha, - i mbeteshin shumë pak vjet jetë." Doktor Dionisio Iguanari, që vërtet i kishte mjekuar një hepatit Santiago Nasarit në moshën dymbëdhjetëvjeçare, e kujtonte me indinjatë atë autopsi. Vetëm një famullitar mund të jetë aq gomar, më tha. S'i mbushej që s'i mbushej rradakja se ne banorët e tropikëve e

kemi mëlçinë më të madhe nga të spanjollëve. Raporti përfundonte duke vërejtur se vdekja qe shkaktuar nga një humbje e madhe gjaku prej çdonjërës nga shtatë plagët e mëdha.

Na kthyen një trup që s'njihej fare. Gjysma e rrashtës qe shkatërruar nga shpimi me turjelë, ndërsa për fytyrën prej bukuroshi, të cilën as vdekja s'e kishte prekur dot, tani as që mund të bëhej fjalë. Veç kësaj, farnullitari i kishte shkulur nga zgavra rropullitë e shpartalluara dhe, duke mos ditur pastaj ç'të bënte me to, u pat dhënë një bekim në zemërim e sipër dhe i kishte flakur në teneqenë e plehrave. Kureshtarëve të fundit, që qenë dyndur te dritarja e shkollës, u iku çdo pikë kuresiltjeje, ndihmësi u alivanos, ndërsa kolonel Lasaro Aponteja, që kish parë e kish shkatërruar sa e sa masakra në emër të mbrojtjes së rendit, u bë edhe vegjetarian përveçse spiritist. Zhgualli i zbrazët i trupit, mbushur përbrenda me rrecka e me gëlqere të pashuar dhe qepur shkel e shko me spango të trashë e me gjilpërë dyshekësh, mend na mbeti në dorë kur e ngritëm për ta vënë në qivurin e ri veshur përbrenda me atllas të mbushur. "Mendova se ashtu do të mund të ruhej për një kohë më të gjatë", më tha at Amadori. Mirëpo ndodhi e kundërta: na u desh ta varrosnim sa më shpejt ndaj të gdhirë, se qe katandisur në një gjendje të tillë sa nuk mbahej më në shtëpi.

Gdhiu një e martë e vranët. Mua s’ma mbante të flija vetë, pas një dite aq dërrmuese dhe shtyva portën e shtëpisë së Maria Alehandrina Servantesit me shpresë se nuk do të qe mbyllur. Nëpër pemë qenë ndezur kungujt e dritës dhe në oborrin e vallëzimit qenë ndezur aty-këtu zjarre me dru, mbi të cilat avullonin kazanë të mëdhenj, ku mulatet po ngjyenin në të zeza rrobat e tyre të mira. Si zakonisht ndaj të gdhirë, Maria Alehandrina Servantesin e gjeta të zgjuar dhe krejt lakuriq, si ngaherë kur s'kishte njerëz në shtëpi. Qe ulur allaturka mbi shtratin prej mbretëreshe, mbretëreshe, përpara një tabakaje me një pirg të madh të

ngrënash: kotëleta viçi, pulë të zier, bërxolla derri dhe një mal bananesh e perimesh sa për pesë vet. Të ngrënit tej mase pat qenë gjithmonë për të e vetmja mënyrë për të qarë dhe unë kurrë nuk e pata parë ta bënte këtë gjë me aq dhembje sa atë çast. U shtriva pranë saj, pa u zhveshur, pa folur, duke qarë edhe unë pas mënyrës sime. Mendoja për fatin e zi të Santiago Nasarit, i cili kishte paguar të njëzet vjetët e lumturisë jo vetëm me vdekjen, por edhe me copëtimin e trupit, me shpartallimin e me asgjësimin e tij. M'u bë sikur në dhomë po hynte një grua me një fëmijë në krahë dhe sikur fëmija hante me zhurmë e me ngut, ndërsa kokrrat e misrit gjysmë të përtypura i binin gruas mbi gjimbajtëse. Ajo më tha: "Ha si një urithkë budallaqe, pa pikë kujdesi e pa pikë turpi." Befas ndjeva gishtërinjtë e shqetësuar që më zbërthenin kopsat e këmishës, ndjeva erën e rrezikshme të shtazës së dashurisë shtrirë ngjat meje dhe kuptova se po kridhesha nëpër ëndjet e bryllësisë së saj si rërë e tallazitur. Por ajo papritmas shtangu, u koll prej diku së largu dhe u zhduk prej jetës sime.

- Nuk mundem, - tha, - ti mban erën e tij.

Dhe jo vetëm unë. Gjithçka atë ditë mbante erën e Santiago Nasarit. Vëllezërit Vikario e ndien këtë erë në qelinë ku i mbylli alkaldi, ndërkohë që ende s'dinte ç'të bënte me ta. "Sado që fërkohesha me sapun e me shparcë, nuk shpëtoja dot prej asaj ere", më tha Pedro Vikarioja. Kishin tri net pa fjetur e përsëri nuk flinin dot, sepse sa i zinte gjurni, u dukej sikur rishtas ta kryenin krimin. Pothuajse i plakur, duke u përpjekur të më shpjegonte gjendjen e tij gjatë asaj dite pa mbarim, Pablo Vikarioja më tha thjesht: "Qe sikur të ishe dy herë zgjuar." Kjo frazë më bëri të mendoj se gjëja më e padurueshme për ta në qeli duhej të kish qenë të pagjumët.

Qelia ishte tre metra me tre, kishte një frëngji me shufra hekuri, një oturak, një takëm të lari me legenin dhe katruven dhe dy shtretër betoni me dyshekë kashte. Kolonel Aponteja, me urdhër të të cilit qe ndërtuar qelia, thoshte se vend bujtjeje më njerëzor se ai s'kishte pasur ndonjëherë. Këtë e pranonte edhe im vëlla Luis Enrike, që një natë e mbyllën në atë qeli për një zënkë sazexhinjsh dhe alkaldi e bëri zemrën të gjerë e dha leje që bënte shoqëri aty njëra nga mulatet. Mbase të këtij mendimi patën qenë edhe vëllezërit Vikario në orën tetë të mëngjesit, kur e ndien se kishin shpëtuar nga kërcënimi i arabëve. Ata ishin të qetë, se mendonin që kishin kryer detyrën dhe i shqetësonte vetëm era që s'u shqitej. Kërkuan ujë të bollshëm, sapun rrobash dhe shparcë, lanë gjakun nga krahët dhe fytyrat e madje lanë edhe këmishët, por prej erës nuk shpëtuan dot. Pedro Vikarioja kërkoi t'i sillnin purgativet e diuretikët dhe një tufë garzash sterile për t'u ndërruar, madje mundi të urinonte dy herë gjatë mëngjesit. Megjithëkëtë, sa më tepër zbardhte dita, aq më keq e ndienin veten dhe shqetësimi për erën u bë një gjë e dorës së dytë. Më dy pasdreke, në pisk të vapës, Pedro Vikarioja ishte aq i lodhur, sa nuk mund të qëndronte shtrirë në fshat, por as në këmbë nuk mbahej dot. Dhembja e rrëzëkofshës i erdhi deri në qafë, iu mbajt ujët e hollë dhe pati përshtypjen e tmerrshme që s'kishte për të fjetur derisa të vdiste. "Njëmbëdhjetë muaj s'mbylla dot sy", më tha dhe unë e njihja mjaft mirë për ta besuar se thoshte të vërtetën. S'futi dot gjë në gojë. Pablo Vikarioja, nga ana e tij, hëngri pakëz nga të gjitha ato që i prunë, por pas një çerek ore shpërtheu në të vjella e heqje barku, si ta paskësh zënë kolera. Në orën gjashtë pasdite, ndërsa i bënin autopsinë kufomës së Santiago Nasarit, alkaldin e thirrën me urgjencë ngaqë Pedro Vikarioja qe i sigurt se i kishin helmuar të vëllanë. "Sa s'po

nxirrja zorrët - më tha Pablo Vikarioja, - dhe na qe mbushur rradakja se në këtë mes kishin gisht turqit[6]". Dy herë e kishte mbushur citë oturakun e qelisë dhe gjashtë herë të tjera e kishte shpënë gardiani në nevojtoren e alkaldisë. Edhe kolonel Aponteja atje e gjeti, të kruspullosur në qenefin pa dyer, nën mbikëqyrjen e gardianit, duke hequr një spirë aq të ujshme, sa vërtet mund të të shkonte mendja për ndonjë helmim. Por këtë mendim e flakën tutje, me t'u marrë vesh se pati pirë ujin e pati ngrënë hejet që u kishte dërguar Pura Vikarioja. Megjithëkëtë, Alkaldi u trondit aq shumë, saqë dha urdhër t'i shpinin të arrestuarit në shtëpi me rojë të veçantë, derisa të vinte hetuesi e t'i hidhte në burgun e Rioaçës.

Frika e binjakëve lidhej drejtpërsëdrejti me ndezjen e gjakrave në rrugë. S'përjashtohej mundësia e një hakmarrjeje nga ana e arabëve vendës, por askujt, veç vëllezërve Vikario, s'i pat vajtur mendja te helmi. Gjindjes i thoshte mendja se arabët do të prisnin natën për të hedhur benzinë nga frëngjia e qelisë që t'i digjnin të arrestuarit si minj. Por edhe këto qenë hamendje të kota. Arabët përbënin një bashkësi të shpërngulurish paqësorë, që në fillim të këtij shekulli qenë ngulur në fshatrat e bregut të Karaibeve - në më të largëtit e më të varfrit - dhe merreshin me shitje leckurinash ngjyra-ngjyra e stringlash panairi. Qenë të lidhur me njëri-tjetrin, punëtorë dhe kishin marrë fenë katolike. Martoheshin brenda për brenda, importonin drithë, rritnin bagëti të imët nëpër oborre, mbillnin manxuranë dhe patëllxhan dhe qenë të dhënë me mish e me shpirt pas kumarit. Të moshuarit kishin vazhduar të flisnin arabishten fshatarake që patën sjellë prej atdheut dhe e ruajtën atë të paprekur deri në brezin e dytë, ndërsa brezi i tretë, me përjashtim të

[6] *Në Kolumbi të gjithë banorët pasaardhës të arabëve në gjuhën popullore thirren "turq".*

Santiago Nasarit, i dëgjonin prindërit që u flisnin arabisht, por u gjegjeshin spanjisht. Kështu që s'mund të përfytyrohej që ata, nga fshatarë të urtë t'u kthyekëshin në hakmarrës të një vdekjeje, fajtorë për të cilën mund të ishim të gjithë ne. Nga ana tjetër, askujt s'i vajti mendja për ndonjë hakmarrje prej familjes së Plasida Lineros. Pat ikur ajo kohë kur familja e Linerove nxirrte trima të krisur e xhagajdurë, që bënin namin nëpër taverna e s'kish burrë t'ua bënte fjalën dysh.

Kolonel Aponteja, i shqetësuar nga ç'flitej poshtë e përpjetë, i vizitoi arabët familje për familje dhe, të paktën kësaj radhe, arriti në një përfundim të drejtë. I gjeti të turbulluar, të hutuar e të pikëlluar, me shenja zije ndër lterë, madje disa të ulur përdhe duke vajtur me të klithura, por pa asnjë shenjë dëshire për hakmarrje. Trazirat e mëngjesit patën ngjarë në nxehje e sipër, menjëherë pas krimit, dhe vetë autorët e tyre e pranuan se assesi s'do të kishte shkuar puna deri në të shtëna. Për më tepër, pikërisht Suseme Abdallaja, plaka njëqindvjeçare, pat rekomanduar lëngun shërues të luleve të Krishtit e të sherebelës, që ia mbajtën heqjen e barkut Pablo Vikarios dhe, nga ana tjetër, ia çliruan të vëllait ujët e hollë. Pedro Vikarioja ra atëherë në një përgjumje, ndërsa i vëllai i shëruar pa të parën ëndërr pa brejtje ndërgjegjeje. Kështu i gjeti Purisima Vikario të martën në tre të mëngjesit, kur alkaldi e shpuri të ndahej me ta.

Me iniciativën e kolonel Apontes, tërë familja, gjer edhe vajzat e mëdha me bashkëshortët, ikën pa i rënë askujt në sy, teksa ne, të vetmit që s'patëm vënë gjumë në sy nga ata që përjetuan atë ditë të papërsëritshme, po varrosnim Santiago Nasarin. Sipas vendimit të alkaldit, ata ikën derisa të qetësoheshin gjakrat, por nuk u kthyen më kurrë. Pura Vikarioja ia mbështolli fytyrën me shami vajzës së kthyer, që të mos ia shihte kush të mavijosurat dhe e veshi në të kuqe flakë, që të mos mendonin të tjerët se mbante zi për dashnorin e fshehtë. Para se

të niseshin, Pura Vikarioja iu iut at Amadorit që t'u shkonte në burg bijave të saj, por Pedro Vikarioja s'pranoi të rrëfehej dhe ia mbushi mendjen edhe të vëllait që ata s'kishin përse pendoheshin. Mbetën vetëm dhe ditën kur hetuesi i hodhi në Rioaça e kishin marrë veten aq mirë dhe ishin aq të vendosur në të drejtën e tyre, sa nuk pranuan t'i nxirrnin natën, siç patën bërë me familjen, por në mes të ditës e me fytyra zbuluar. Ponsio Vikarioja, baabi, vdiq pas pak kohe. "E hëngri brenga", më tha Anhela Vikarioja. Binjakët, pasi u liruan, qëndruan në Rioaça, një ditë rrugë larg prej Manaurit, ku jetonte familja. Atje shkoi Prudensia Kortesi për t'u martuar me Pablo Vikarion, i cili kishte mësuar zanatin e argjendarit në dyqanin e t'et dhe u bë usta i mbaruar. Pedro Vikarioja - pa dashuri e pa punë - pas tri vjetësh hyri përsëri në ushtri dhe arriti gjer të bëhej kryerreshter. Një ditë u fut me patrullën e tij në një territor gueriljesh, duke kënduar këngë kuplarash, dhe për të s'u mor më vesh asgjë.

Për shumicën e njerëzve, në këtë mes pati vetëm një viktimë: Bajardo San Romani. Arrihej në përfundimin se protagonistët e tjerë të tragjedisë c patën përmbushur me dinjitet, madje edhe me njëfarë madhështie detyrën që i kish përcaktuar jeta gjithsecilit. Santiago Nasari e kishte paguar turpin, vëllezërit Vikario e kishin treguar burrërinë e tyre dhe motrës së përtallur i qe vënë nderi në vend. I vetmi që kishte humbur gjithçka qe Bajardo San Romani, "i gjori Bajardo", siç e kujtuan vite me radhë. Megjithëkët, askujt s'i kishte rënë ndër mend për të gjer në eklipsin e hënës, të shtunën pas tragjedisë, kur vejani Ksius i rrëfeu alkaldit se kishte parë një zog fosforik të fluturonte mbi shtëpinë e tij të dikurshme dhe i qe dukur se ishte shpirti i së shoqes që kërkonte shpirtin e tij. Alkaldi i ra ballit me pëllëmbë, por kjo s'kishte asnjë lidhje me faniten e vejanit.

- Dreq o punë, - thirri. - Më kishte dalë fare nga mendja ai i gjorë!

U ngjit në kodër me një patrullë, gjeti para vilës veturën me mbulesë të ngritur, pa një dritë vetmitare në dhomën e gjumit, por askush nuk iu përgjigj thirrjeve e të trokiturave. Atëherë shkallmuan një derë anësore dhe kontrolluan dhomat e ndriçuara nga vezullimet e hënës në të zënë e sipër. "Gjithë gjërat e shtëpisë dukeshin si të kredhura në ujë", më tregoi alkaldi. Bajardo San Romani shtrihej pa ndjenja në shtrat, ashtu siç e kishte parë Pura Vikarioja të hënën në mëngjes, me pantallonat ngjyra-ngjyra dhe me këmishën prej mëndafshi, veçse pa këpucë. Në dysheme kishte shishe të boshatisura dhe shumë të tjera të përhapura pranë shtratit, por s'dukej asnjë gjurmë të ngrëne. "Ndodhej në gradën e fundit të in.toksikacionit alkoolik", më tha doktor Dionisio Iguarani, i cili qe thirrur urgjentisht. Por e kishte marrë veten pas disa orësh dhe, me të ardhur në mendtë e tij, i përzuri të gjithë prej shtëpisë me sebepe të ndryshme, të cilat, si ngaherë, i kishte në majë të gjuhës.

- Mos të më çajë bythën njeri, - tha. - As edhe ai plaku im veteran me pordhët e tij.

Me një telegram alarmues alkaldi vuri rië dijeni gjeneral Petronio San Romanin për të gjithë ngjarjen, gjer edhe për frazën e fundit fjalë për fjalë. Gjeneral San Romani, me ç'duket, e kuptoi siç duhej të birin, se nuk erdhi vetë, por dërgoi të shoqen me të bijat e me dy zonja të tjera të moshuara që ngjanin si motrat e tij. Ato erdhën me një anije mallrash, të veshura përzishëm deri në fyt për fatkeqësinë e Bajardo San Romanit dhe me flokët e shpleksur prej dhembjes. Para se të hidhnin këmbë në stere, zbathën këpucët dhe e bënë rrugën deri te kodra duke u çapitur zbathur nëpër pluhurin e nxehtë të mesditës, duke shkulur flokët tufë-tufë e duke garë me të klithura aq të mprehta, saqë ngjanin si britma hareje. Unë i pashë nga ballkoni i Magdalena Oliverit dhe mbaj mend

se thashë me vere që një pikëllim të tillë njerëzit mund ta shtirnin vetëm për të mbuluar turpe më të mëdha.

Kolonel Lasaro Aponteja i shoqëroi në vilën e kodrës, pastaj u ngjit atje i thirrur urgjentisht edhe doktor Dionisio Iguarani, hipur mbi mushkën e ndihmës së shpejtë. Kur ra pakëz vapa, dy shërbesa të bashkisë zbritën me një hamak të mbajtur me një hu Bajardo San Romanin, të mbuluar kokë e këmbë me një batanije e të pasuar prej shpurës së vajtojcave. Magdalena Oliveri kujtoi se kishte vdekur.

- O zot e perëndi, - thirri - ç'gjëmë!

Bajardo San Romani qe rrumbullosur aq sa zor mund ta merrje për të gjallë. Dora e djathtë i varej zharg përtokë dhe sapo e ëma ia fuste brenda hamakut, ajo i binte përsëri, duke lënë një vazhdë nëpër pluhur qysh ku fillonte rrëpira e deri te anija. Ky qe kujtimi i fundit që na mbeti prej tij: kujtimi i një viktime.

Vilën nuk e prekën fare. Nëpër net zdërhalljesh, kur ktheheshim për pushirne, ngjitesha me vëllanë për ta kontrolluar dhe çdo herë gjenim gjithnjë e rnë pak gjëra me vlerë nëpër dhomat e braktisura. Një herë gjetëm valixhen e vogël që Anhela Vikarioja i kish kërkuar së ëmës natën e dasmës, por nuk i dhamë asnjë rëndësi. Ato çka kishte brenda na u dukën mjete të zakonshme për tualetin dhe higjienën e grave dhe destinimin e tyre të veçantë e mora vesh vetëm kur Anhela Vikarioja më rrëfeu pas shumë vjetësh marifetet që i kishin mësuar shoqkat për të mashtruar të shoqin. Ishte gjurma e fundit që pat lënë ajo në atë shtëpi, e cila pat qenë vatra e saj familjare vetëm për pesë orë.

Vite më vonë, kur u ktheva përsëri për të rnbledhur dëshmitë e fundit për këtë kronikë, s'pat mbetur gjë prej gjëje nga gjithë ajo çka përbënte lumturinë e Jolanda de Ksiusit. Me gjithë vigjilencën këmbëngulëse të kolonel Apontes, pak e nga pak çdo gjë pati firosur,

duke përfshirë edhe bufenë gjashtëpasqyrëshe në bojë njeriu që mjeshtërve të shquar të Mompoksit u qe dashur ta ndërtonin brenda shtëpisë, se nuk e nxinin dyert. Në fillim vejani Ksius u gëzua, se i thoshte mendja që kjo qe vepër e bashkëshortes së tij, e cila po u përpiqkësh të mirrte gjërat e saj. Kolonel Lasaro Aponteja tallej me të. Por një natë i shkrepi të bënte një seancë spiritizmi për të shkoqitur misterin dhe personalisht shpirti i Jolanda Ksiusit e kishte siguruar se ajo vetë po i merrte për në banesën e saj të përtejvarrit rrangullinat e kohës së lumturisë. Vila filloj të shkatërrohej. Vetura e dasmës u zbërthye e u bë copë-copë para portës, gjersa i mbeti vetëm skeleti i ndryshkur e i kalbur prej shqotave. Vite me radhë s'u mor më vesh asgjë për zotin e saj. Ka një deklaratë të tij në procesverbal, por është aq e shkurtër dhe e errët, saqë duket të jetë bërë në çastin e fundit, sa për të qenë brenda formaliteteve. Të vetmen herë që u përpoqa të flisja me të, njëzet e tre vjet më vonë, rnë priti me njëfarë agresiviteti dhe s'pranoi të jepte as hollësinë më të vogël që mund të ndihmonte për të sqaruar sadopak rolin e tij në dramë. Sidoqoftë, as prindërit e tij s'dinin për të më shumë sesa ne dhe s'kishin idenë më të vogël përse pat ardhur ai në një fshat të humbur pa asnjë qëllim tjetër të dukshëm, veç atij për t'u martuar me një grua që s'e kishte parë kurrë.

Për Anhela Vikarion, përkundrazi, pata gjithmonë lajme të shkurtuara që më frymëzuan të kisha për të një përfytyrim të idealizuar. Ime motër murgesha u end për ca kohë në Guahirën e Epërme duke u përpjekur t'u ndërronte fenë idhulltarëve të mbramë. Ajo e pat bërë zakon të kalonte për të këmbyer dy fjalë me të në një nga fshatrat e përzhitura nga kripa e Karaibeve, ku e ëma qe orvatur ta varroste së gjalli. "Ke të fala nga jot kushërirë", më thoshte gjithmonë. Ime motër Margoi, që shkonte ta shihte nganjëherë vitet e para, më tregoi se kishin blerë një shtëpi të fortë, me një oborr shumë të madh ku frynin erërat si

mos o zot, e keqja e vetme e së cilës qenë netët me baticë, kur nevojtoret vërshonin dhe mëngjeseve nëpër dhomat pllaquriteshin peshqit. Të gjithë ata që e panë në këtë kohë puqeshin në mendimin se qe dhënë e tëra pas makinës qepëse dhe se nëpërmjet punës së vet kishte fituar përsëri qetësinë.

Shumë vite më vonë, në një kohë të turbullt kur unë mundohesha t'i gjeja vetes njëfarë pune duke shitur enciklopedi dhe libra mjekësorë nëpër fshatrat e Guahirës, më hodhi hera rastësisht në atë katund indianësh. Në dritaren e një shtëpie kundruall detit, në orën e zhegut, pashë një grua të përkulur mbi makinën qepëse, të veshur gjysmë përzishëm, me syze me skelet metalik dhe me leshra të verdha në të bardhë, ndërsa mbi krye i varej një kuvli me një kanarin që s'reshtte së kënduari. Duke e parë në këtë suazë idilike, nuk m'u besua se ajo qe gruaja që pata stisur në përfytyrimin tim, madje s'desha ta pranoja që jeta të katandisej sa t'i ngjante një romani të keq. Por ishte ajo, Anhela Vikarioja, njëzet e tre vjet pas dramës.

U soll me mua si ngaherë, si me një kushëri të largët dhe iu gjegj pyetjeve të mia me mendjen top e me një fije humori. Aq qe pjekur e mençuruar, sa s'të bëhej të besoje se ishte po ajo Anhela Vikario. Çka më çuditi edhe më qe mënyra se si i pat dhënë karar jetës së vet. Pas disa minutash madje nuk më ngjau aq e plakur sa ç'më qe dukur në pamje të parë, por po aq e re sa ç'e mbaja mend. Sikur nuk kishte më asgjë të përbashkët me atë njëzetvjeçaren që e kishin shtrënguar të martohej pa dashuri. E ëma, një plakë me të cilën s'i gjeje dot fjalët, më priti siç pritet një hije nate që të përhihet kur ti s'e sjell më ndër mend. S'pranoi të fliste për të shkuarën dhe m'u desh të kënaqesha për këtë kronikë me disa fraza të shkëputura nga kuvendimet e saj me time ëmë, si dhe me ndonjë tjetër të nxjerrë nga kujtesa ime. Kishte bërë çmos e

çnuk që ta fuste në dhe për së gjalli të bijën, por kjo s'ia nxori planin në kut, se asnjëherë nuk e veshi me mister fatkeqësinë e vet. Përkundrazi, gjithkujt dëshironte ta dëgjonte, ajo ia rrëfente fije e për pe, me përjashtim të një hollësie që nuk do të merrej vesh asnjëherë: kush qe në të vërtetë ai që e pat marrë në qafë dhe si e qysh e tek pat ndodhur kjo. Sepse askush nuk e besoi që të kish qenë vërtet Santiago Nasari. Ata u përkisnin, si me thënë, dy botëve të ndryshme. Askush s'i kish parë një herë së toku, e aq më tepër vetëm. Santiago Nasari s'ia varte asaj, ngaqë vriste lart. "Jot kushërirë torollakçka", më thoshte kur deshte ta zinte ngoje. Pastaj ai qe edhe "gjerak zogëzash", siç thoshim ne asokohe. Dhe, si i ati, dilte e gjuante ndonjë çupëz nëpër rrethinat, kurse brenda fshatit as u pa e as u mor vesh ndonjë lidhje tjetër e tij, veç atyre të dyjave që diheshin prej gjithë botës: lidhjes serioze me Flora Migelin dhe lidhjes së zjarrtë, që desh e luajti mendsh për katërmbëdhjetë muaj rresht, e Maria Alehandrina Servantesin. Mendimi më i përgjithshëm, dhe ndoshta pikërisht ngaqë qe më i mbrapshti, ishte mendimi se Anhela Vikarioja mbronte dikë që e deshte me të vërtetë dhe pat zgjedhur emrin e Santiago Nasarit, mbasi nuk i shkonte mendja kurrë se të vëllezërit mund të ndërseheshin kundër tij. Santiago Nasarit, kur vajta ta takoja për së dyti, u përpoqa t'ia shkëpusja këtë të vërtetë, duke i parashtruar me logjikë një sërë arsyetimesh, por ajo vetëm sa ngriti kokën nga qëndisma dhe e uli për të kundërshtuar.

- Mos u lodh kot, kushëri, - më tha. - Ai qe.

Të gjitha të tjerat i tregoi fije e për pe, gjer edhe mynxyrën e natës së martesë. Tregoi se si e kishin mësuar shoqkat që ta dehte e ta rrumbullonte të shoqin derisa të mos ishte më në vete, se si të shtirej sa më e turpshme që ai ta fikte dritën, se si të bënte në çastin e fundit një banjë me ujë me shap që të hiqej si e virgjër, se si ta lyente çarçafin me merkurokrom, që ta nxirrte të nesërmen për sehir në oborrin e saj.

Vetëm dy gjëra nuk kishin pasur parasysh ndrikullat: se Bajardo San Romani s'e kishte shokun në të mbajturit e pijes dhe se pas asaj tulatjes së Anhela Vikarins, që ia kish futur në gjak e ëma, fshihej një shpirt i dëlirë. "S'bëra asgjë nga ato që më thanë, - më tregoi, - sepse sa më tepër e mendoja, aq më shumë e kuptoja se gjithë kjo ishte një ndyrësi që s'i duhej bërë askujt e aq më tepër një njeriu të gjorë që i pat rënë shorti i lig të martohej me mua". Kështu që e la ta zhvishte pa e zgjatur në dhomën e gjumit me dritë të ndezur, pa asnjë pikë prej asaj frikës që i kishin nxirë jetën. "Qe një gjë shumë e lehtë, - më tha, - sepse isha përgatitur të vdisja".

Fliste pa asnjë druajtje për fatkeqësinë e saj, që të fshihte një tjetër fatkeqësi, atë të vërtetën, që e digjte përbrenda. As që mund t'i shkonte ndër mend kujt, deri në çastin kur ajo vendosi të ma tregonte haptas, se Bajardo San Romani pat hyrë përgjithmonë në jetën e saj qysh prej çastit kur e kishte kthyer në shtëpinë e prindërve. Ky pat qenë për të momenti i zbulimit të madh. "Kur mamaja filloi të më rrihte, mua menjëherë më shkoi mendja tek ai", më tha. Të goditurat i dhembnin më pak, sepse e dinte që qenë për të. E plandosur në divanin e dhomës së bukës, duke dënesur, ajo vazhdoi të mendonte për të dhe i vinte çudi me veten. "Nuk qaja për drurin që po haja, as për atë çka pat ndodhur, - më tha. - Qaja për të". Vazhdoi të mendonte për të edhe kur e ëma filloi vinte në fytyrë kompresat me *arnikë*, edhe kur dëgjoi gurgulenë në rrugë dhe kambanat që binin si për zjarr dhe e ëma hyri t'i thoshte që tani mund të flinte e qetë se ç'kish për t'u bërë u bë.

Mendoi gjatë dhe pa asnjë shpresë për Bajardo San Romanin, gjersa një ditë, kur iu desh të shoqëronte të ëmën në një vizitë që do të bënte në spitalin e Rioaçës, hynë kalimthi në bujtinën e portit, të zotin e së cilës e njihnin dhe Pura Vikarioja kërkoi te banaku një gotë ujë. I kishte

kthyer shpinën së bijës dhe po pinte ujin, kur befas Anhela Vikarioja pa trupëzimin e mendimit të vet të reflektuar në pasqyrat shumëfaqëshe të salunit. Mbeti pa frymë. Ktheu kokën dhe e pa të kalonte ngjat saj pa e vënë re. E pa të dilte nga bujtina. Pastaj i hodhi edhe një herë sytë nga e ëma me zemrën të lavosur. Pura Vikarioja e kishte pirë ujin, fshiu buzët me mëngë dhe, që prej banakut, i buzëqeshi pas syzeve të reja. Për herë të parë në jetën e saj, Anhela Vikarioja në këtë buzëqeshje e pa të ëmën ashtu siç qe në të vërtetë: një grua e mjerë, e përkushtuar kultit të ceneve të vetvetes. "Mutja", tha me vete. Qe tronditur aq shumë, saqë në rrugën e kthimit e bëri duke kënduar me zë të lartë dhe pastaj zuri shtratin e qau tri ditë rresht.

Kjo qe lindja e saj e dytë. "Po luaja mendsh për të, - më tha, - po çmendesha fqre". Mjaft të mbyllte sytë dhe e shihte, ia dëgjonte frymëmarrjen në uturimën e detit, afshi i nxehtë i trupit të tij ia nxirrte gjumin në mes të natës. Si s'gjeti dot qetësi gjatë gjithë asaj jave, i shkroi Bajardo San Romanit letrën e parë. Qe një pusullë e shkurtër, në të cilën i thoshte se e kishte parë të dilte nga bujtina dhe se do t'i bëhej shumë qejfi sikur edhe ai ta kishte parë. Priti më kot përgjigje. Në krye të dy muajve, e lodhur së prituri, i dërgoi letrën e dytë, po aq të shkurtër e fjalëpakë sa të parën, në të cilën dukej sikur vetëm e qortonte përse qe sjellë i panjerëzishëm. Pas gjashtë muajsh kishte shkruar gjashtë letra, për të cilat gjithashtu s'kishte marrë përgjigje. Por asaj i mjaftonte të dinte se ai i merrte.

Për herë të parë zonjë e fatit të vet, Anhela Vikarioja zbuloi atëherë se urrejtja dhe dashuria janë pasione të ndërsjella. Sa më shumë letra dërgonte, aq më keq ia ndizte vetes ethet e dashurisë dhe aq më tepër i rritej ajo ndjenja e mërisë së fshehtë që ndiente ndaj së ëmës. "Më vinte për të vjellë kur e shikoja, më tha - por ama nuk mund ta shihja pa kujtuar atë tjetrin. ..." Jeta e saj prej nuseje të kthyer vazhdoi të ishte po

aq e rëndomtë si ajo e viteve të vajzërisë: qëndiste në makinë me shoqet, ashtu siç pat bërë dikur tulipanë prej cohe e zogj prej letre. Vetëm se tani, kur e ëma binte për të fjetur, ajo vazhdonte të rrinte në dhomë gjer ndaj të gdhirë duke shkruar letra, të cilave s'dihej se si do vinte filli. I erdhën mendtë, mundi t'i zotëronte siç donte dëshirat e veta e madje të bëhej e virgjër vetëm për atë, duke mos njohur asnjë pushtet tjetër veç atij të vetvetes dhe asnjë zgjedhë tjetër veç ndjenjës së vet.

Gjatë gjysmës së jetës së saj i shkroi atij një letër një javë. "Nganjëherë s'kisha ç'të shkruaja, - më tha duke u shkrirë gazit, - por më mjaftonte të dija se ai i merrte." Në krye qenë shënime të thjeshta, pastaj letërza të një dashnoreje të fshehtë, pusulla të parfumuara të një nuseje të largët, dokumente punësh tregtare, mesazhe dashurie dhe, tek e fundit, letra të çoroditura të një gruaje të braktisur, që i sajonte vetes sëmundje të tmerrshme për ta detyruar të shoqin të kthehej. Një natë, kur qe në qejf, iu derdh boja e shkrirnit mbi letrën e sapombaruar dhe, në vend që ta griste, i shtoi poshtë një shënim: "Për provë dashurie po të dërgoj lotët e mi". Nganjëherë, kur lodhej së qari, tallej me çmendurinë e vet. Gjashtë herë u ndërrua nëpunësja e postës dhe që të gjashta herët ajo arriti ta zinte shoqe. E vetmja gjë që s'bëri ishte të hiqte dorë. Megjithëkëtë, Bajardo San Romani dukej se as që çante kryet për përçartjet e saj: thua se ajo i shkruakësh një fantazme.

Një mëngjes gjithë erëra, vitin e dhjetë, u zgjua me ndjesinë e sigurt se ai i qe futur në shtrat i zhveshur. I shkruajti atëherë një letër të ethshme prej njëzet faqesh, në të cilat i tregonte atij, pa turp e pa druajtje, gjithçka të vërtetë por të hidhur që ia sfiliste zemrën qysh prej asaj nate të kobshme. I tregonte për plagët e përjetshme që i pat lënë ai në trup, për kripën e buzëve dhe të gjuhës së tij, për zjarrminë marramendëse të epshit të tij prej afrikani. Ia dha punonjëses së postës,

që vinte të premteve mbas dite për të qëndisur me të e i merrte letrat, dhe iu mbush mendja se kjo ishte e fundmja shfryrje e agonisë së saj. Por nuk mori përgjigje. Që nga ajo ditë nuk e dinte as vetë se ç'shkruante, as kujt i shkruante, vetëm vazhdoi së shkruari për shtatëmbëdhjetë vjet radhazi.

Një mesditë gushti, teksa qëndiste së toku me shoqet, dëgjoi se pat ardhur dikush te dera. S'kishte pse të shihte për ta kuptuar kush qe. "Qe ngjallur e trashur, kishin filluar t'i binin flokët dhe i duheshin syze për afër, - më tha. - Por ishte ai, dreqi e mori, ishte ai!" U frikësua, se e kuptoi që për sytë e tij edhe ajo ishte e plakur dhe se s'besonte që ai ta deshte sa dhe ajo, që të mund ta duronte. Këmishën e kishte qull në djersë, si atë ditë në panair kur e kishte parë për së pari, kishte të njëjtin rrip dhe të njëjtën çantë prej lëkurë të zbukuruar me folla argjendi. Bajardo San Romani bëri një hap përpara, pa ua varur dy qëndistareve të tjera që kishin mbetur pa mend dhe hodhi çantën mbi makinën qepse,

- E pra, tha, ja ku erdha.

Kishte një valixhe me plaçka për të ndenjur dhe një tjetër të njëllojtë me dymijë letrat që i kishte shkruar ajo. Ishin renditur pas datave, të mbledhura në tufa e të lidhura me fjongo me ngjyra. Të gjitha ishin të pahapura.

***

Për vite e vite ne vetëm këtë ngjarje patëm në gojë. Jeta jonë e përditshme, që deri atëherë pat ndjekur rrjedhën e saj të zakonshme, kishte filluar të vërtitej rreth një shqetësimi të përbashkët. Kënga e gjelave në mëngjes na gjente zgjuar, duke u përpjekur t'u jepnim një shpjegim rastësive të panumërta të lidhura të cilat kishin bërë të mundur të ngjante e pangjara, dhe s'do mend që këtë s'e bënim nga dëshira për

të shkoqitur një mister, por, sepse asnjëri prej nesh nuk mund të gjente më qetësi në jetë pa ditur me saktësi se ç'vend dhe ç'detyrë i pat caktuar fati.

Shumë vetë këtë nuk e morën vesh kurrë. Kristo Bedoja, që arriti të bëhej një kirurg i famshëm, nuk e shpjegoi dot asnjëherë përse i tha mendja të rrinte dy orë të mira në shtëpinë e gjyshërve, derisa të vinte ora e ardhjes së ipeshkvit, në vend që të shkonte në shtëpinë e vet ku prindërit po e prisnin gjer ndaj të gdhirë për ta paralajmëruar. Shumica e atyre që mund të bënin diçka për ta ndaluar kryerjen e krimit, e megjithatë nuk e bënë, ngushëllonin veten me mendimin se çështjet e nderit qenkëshin të shenjta dhe në to s'mund të përzihej kush tjetër veç të zotëve të dramës. "Nderi është dashuri", thoshte shpesh ime ëmë. Ortensia Baute, që u fut në këtë ngjarje vetëm se kishte parë dy thikat e përgjakura kur ato ende s'ishin prgjakur, u trondit aq shumë nga kjo saqë e zuri një krizë pendestarie derisa një ditë prej ditësh, duke mos duruar dot më, u lëshua rrugëve lakuriq. Flora Migeli, e fejuara e Santiago Nasarit, nga inati iku me një toger të forcave kufitare, i cili e kurvëroi midis kauçukmbledhësve të Viçadës. Aura Vijerosin, maminë që kishte ndihmuar për të lindur plot tri breza, kur mori vesh për vdekjen e Santiago Nasarit, e zuri një ngërç në fshikën e ujit të hollë dhe deri ditën që vdiq e derdhi ujët me sondë. Don Rohelio de la Flori, burri babaxhan i Klotilde Armentës, që qe mbajtur për bukuri deri në moshën 86-vjeçare, u çua më këmbë për herë të fundit për të parë se si e shkonin në thikë Santiago Nasarin te porta e mbyllur e shtëpisë, dhe menjëherë ra e vdiq. Plasida Lineroja, që e kishte mbyllur atë portë në çastin e fundit, u shfajësua qysh në fillim. "E mbylla, mbasi Divina Flori më bëri be që e kish parë tim bir të hynte në shtëpi, - tregoi. - Por ja që s'paskësh qenë e vërtetë". Mirëpo kurrë s'ia fali vetes që e kishte

ngatërruar ogurin e mirë të pemëve me ogurin e lig të zogjve dhe ra në atë vesin e rrezikshëm të asaj kohe: filloi të mbllaçsite farëra nasturci.

Dymbëdhjetë ditë pas kryerjes së krimit, hetuesi që erdhi e gjeti fshatin duke zier si ndër ethe. Ai u ul në zyrën e ndyrë prej dërrasash të palatuara të bashkisë, duke rrufitur kafe allaturka të përzier me rum prej kallamsheqeri, për të larguar vegullitë e shkaktuara prej vapës dhe iu desh të kërkonte trupa përforcimi për të përmbajtur tumën e njerëzve që, pa i thirrur njeri, dyndeshin kush e kush të depononte, të tregonte rëndësinë e vet në dramë. Ai sapo qe diplomuar dhe kishte ende kostumin prej stofi të zi të institutit juridik, unazën e florinjtë me emblemën e mbarimit të shkollës, si dhe lirizmin e kryelartësinë e fillestarit fatlum. Por emri i tij s'u mor vesh kurrë. Gjithë ç'dimë për të del vetëm nga dosja e hetimeve, të cilën shumë vetë më ndihmuan ta gjeja, njëzet vjet pas kryerjes së krimit, në pallatin e drejtësisë së Rioaçës. Në arkivat nuk kishte asnjë lloj klasifikimi. Dosje procesesh prej më se një shekulli dergjeshin pirgje-pirgje në truallin e ndërtesës koloniale gjysmë të shembur, që dikur pat shërbyer për dy ditë si shtab i gjeneralit Frensis Drejk[7]. Kati përdhes përmbytej prej baticave dhe vëllimet e shqepura vozitnin zyrave të boshatisura. Unë vetë kërkova shpesh herë me ujët gjer te nyjet e këmbëve nëpër atë peng davash të humbura dhe vetëm rasti deshi që, pas pesë vjet kërkimesh, të gjeja 322 faqe të shkulura nga më se 500 që duhej të kishte pasur dosja.

Emri i hetuesit nuk dilte pra kurrkund, por dukej qartas se kishte qenë njeri i dhënë me mish e me shpirt pas letërsisë. Pa fjalë që kishte lexuar klasikët spanjollë dhe disa latinë dhe njihte fort mirë Niçen, që qe autor i modës mes juristëve të asaj kohe. Shënimet përanash faqeve -

[7] *Frensis Drejk (1545-1596) – lundërtar dhe pirate anglez; kreu disa lundrime në brigjet e Amerikës së sotme Latine, duke u marrë me trgti skllevërish e pirateri.*

dhe jo vetë nga ngjyra e bojës - dukeshin si të shkruara me gjak. Aq ia kish prishur mendjen kjo enigmë që i pat rënë për short, saqë shpesh kish humbur nëpër hallakatjet aspak të pranueshme për shkencën e rreptë të drejtësisë. Sidomos atij s'i dukej aspak e natyrshme që jeta të trillonte aq rastësi, të cilat s'i lejohen as letërsisë, për t'u kryer pa kurrfarë pengese një vdekje kaq e paralajmëruar.

Mirëpo ajo e kishte shqetësuar shumë në të mbaruar të hetimeve ishte se s'kishte gjetur as edhe një të dhënë sado të vogël, sado të pabesueshme, që Santiago Nasari të kish qenë me të vërtetë shkaktari i fatkeqësisë. Shoqkat e Anhela Vikarios, ato që e kishin mësuar të gënjente, vazhduan të thoshin për një kohë të gjatë se ajo ua kishte rrëfyer të fshehtën qysh para martesës, por nuk u kishte zënë ngoje asnjë emër. Sipas procesverbalit, ato kishin deklaruar: "Na rrëfeu mrekullinë, por jo shenjtorin". Edhe Anhela Vikarioja qëndroi në të sajën. Kur hetuesi, me stilin e tij të të sjellurit anës, e pyeti nëse e dinte se kush qe Santiago Nasari, ajo iu përgjigj njëmenjë:

- Ai që ma bëri.

Këtë thotë procesverbali, pa asnjë sqarim të mëtejshëm për mënyrën ose vendin e ngjarjes. Gjatë procesit gjyqësor, që vazhdoi vetëm tri ditë, avokati i anës së ëmës u mbështet veçanërisht në paqëndrueshmërinë e padisë. Aq e kishte humbur toruan hetuesi nga mungesa e provave kundër Santiago Nasarit, sa gjithë puna e mirë që ka bërë shpesh duket e tjetërsuar prej dëshpërimit. Kështu, në faqen 416, me bojën e kuqe të spicerit ka bërë me dorën e vet këtë anëshkrim: *"Nëmni një paragjykim dhe do të lëviz botën"*. Pas këtij peri frazimi të dëshpëruar, me të njëjtën bojë ka vizatuar një zemër të shpuar nga një shigjetë. Për të, si dhe për shokët më të ngushtë të Santiago Nasarit,

vetë sjellja e tij të fundit në ora e mbrame qe një provë përfundirntare e pafajësisë.

Në të vërtetë, mëngjesin e vdekjes së tij Santiago Nasari nuk pati dhënë asnjë shenjë frike, në një kohë kur duhej ta kishte ditur se sa i rëndë qe faji që i ngjisnin. E njihte mirë dyfytyrësinë e botës që e rrethonte dhe duhej ta dinte gjithashtu se binjakët, me atë natyrë të çiltër e të drejtë që kishin, nuk mund ta duronin fyerjen. Askush nuk e njihte mirë Bajardo San Romanin, por Santiago Nasari e njihte aq sa të dinte se tek ai, si dhe te shumë të tjerë, pas atyre rninierave mondane fshiheshin një qerre paragjykimesh karakteristike për rrethin e tij shoqëror. Kështu që, të hiqeshe sikur s'çaje kokë, do të thoshte të shkoje drejt vdekjes me këmbët e tua. Veç kësaj, kur mori vesh në çastin e fundit se vëllezërit Vikario po e prisnin për ta vrarë, kundërveprimi i tij nuk qe frika, siç u tha aq shpesh, por hutimia i një të pafajshrni.

Mendimi im vetjak është se ai vdiq pa e marrë vesh përse. Pasi i dha fjalën sime motre Margotit se do të vinte për të ngrënë mëngjes nga ne, Kristo Bedoja e përcolli për krahu nëpër port dhe të dy dukeshin aq të shkujdesur, saqë gjithë kush i pa u qetësua. "Aq s'e çanin kokën, më tha Meme Loaisa, - saqë thashë shyqyr zotit, ngaqë kujtova se puna qe rregulluar". S'do mend që jo të gjithë e deshën Santiago Nasarin. Polo Korriljoja, i zoti i centralit elektrik, mendonte se qetësia e Santiago Nasarit nuk tregonte pafajësinë, por cinizmin e tij. "Pandehte se paratë e bënin të paprekshëm", më tha. Ndërsa Fausta Lopesi, e shoqja, shtoi: "Turk hesapi, më". Indalesio Pardoja hyri në dyqanin e Klotilde Armentë dhe binjakët i thanë menjëherë se, me të ikur ipeshkvi, ata do të vrisnin Santiago Nasarin. Mendoi edhe ai si shumë të tjerë se mos qenë dërdëllitje nga pija ose nga të pagjumët, por Klotilde Armenta e siguroi se ishte e vërtetë dhe iu lut të gjente Santiago Nasarin e ta paralajmëronte.

- Mos u lodh kot, - i tha Pedro Vikarioja.

- Ai i vdekur se i vdekur është.

Sfidë më e hapur s'kish ku të vinte. Binjakët e dinin se sa miq ishin Indalesio Pardoja e Santiago Nasari dhe me ç'duket menduan se ai qe i vetmi njeri i përshtatshëm që mund ta ndalonte krimin e ata të mos mbeteshin me turp. Por Indalesio Pardoja e poqi Santiago Nasarin përkrahu me Kristo Bedojën midis grupeve që largoheshin nga porti dhe s'iu dha ta lajmëronte. "S'e di as vetë se si e humba", më tha. U ra me pëllëmbë supeve sikujt dhe i la të vazhdonin rrugën. Ata mezi e vunë re, se qenë zhytur në përllogaritjet e shpenzimeve të dasmës.

Njerëzit po shpërndaheshin, si dhe ata, në drejtim të sheshit. Qe një turmë e dendur, por Eskolastika Sisneros iu duk se të dy miqtë çanin mes saj pa midis një qarku të zbarët. Njerëzit, sipas saj, e dinin që Santiago Nasari do të vdiste dhe nuk guxonin ta çiknin. Edhe Kristo Bedoja sillte ndër mend një qëndrim të çuditshëm nga ana e të tjerëve. “Na shihnin sikur s'na kishin parë ndonjëherë”, më tha. Santiago Noriega e hapi dyqanin e saj të këpucëve në çastin kur kalonin ata dhe u tremb prej çehres së zbehtë të Santiago Nasarit. Por ai e qetësoi.

- Pa mendo, teto Sarah, - i tha pa u ndalur, - gjithë natën pa gjumë në sy.

Seleste Dragondi qe ulur me pizhame para portës së shtëpisë, duke u tallur me ata që qenë veshur për të përshëndetur ipeshkvin, dhe e ftoi Santiago Nasarin të pinte një kafe. "Që të fitoja kohë dhe të mendoja qysh të bëja", më tha. Mirëpo Santiago Nasari iu gjegj se nxitonte të ndërrohej dhe të vinte nga ne për mëngjes. "Mbeta me gojë hapët, - më shpjegoi Seleste Dangondi. - Se m'u duk që s'kishin se si ta vrisnin, përderisa ai qe aq i sigurt në atë ç'ka do të bënte". Xhamil Shaiumi ishte i vetmi që e bëri atë që kishte vendosur të bënte. Me t'i

rënë në vesh si qe puna, doli te dera e dyqanit dhe priti Santiago Nasarin që ta lajmëronte. Ishte një nga arabët e fundit që pat ardhur me Ibrahim Nasarin, pat qenë shok kumari me të derisa i ndieri pat vdekur dhe vazhdonte të ishte mik i ngushtë familjes. Asnjeri tjetër s'kishte aq autoritet sa ai për të folur me Santiago Nasarin. Megjithëkëtë, që të mos shqetësonte kot së koti Santiago Nasarin në rast se fjalët s'qenë të vërteta, vendosi të këshillohej një herë me Kristo Bedojën, se mos dinte ky gjësend më të saktë. E thirri në kalim e sipër. Kristo Bedoja i ra shpatullave Santiago Nasarit, aty në të dalë të sheshit, dhe bëri për nga Xhamil Shaiumi.

- Mirupafshim të shtunën, - i tha kur u ndanë.

Santiago Nasari nuk iu përgjigj, por i foli arabisht Xhamil Shaiumit dhe ky iu përgjigj po arabisht, duke u shtrembëruar nga të qeshurit. "Ishte një lojë fjalësh që e kishim shumë qejf", më tha Xhamil Shaiumi. Pa u ndalur, Santiago Nasari ua bëri të dyve me dorë dhe mori kthesën. Ishte hera e fundit që e shihnin.

Me të dëgjuar ç'i tha Xhamil Shaiumi, Kristo Bedoja doli me vrap prej dyqanit për të arritur Santiago Nasarin. E kishte parë të kthente qoshen, por nuk e gjeti dot midis grupeve që po largoheshin prej sheshit. Shumë vetë që pyeti për të, i dhanë të njëjtën përgjigje.

- Sapo e pamë me ty.

Iu duk e pamundur që Santiago Nasuri të kishte mbërritur aq shpejt në shtëpi, por megjithëkëtë hyri të pyeste, se portën e përparme e gjeti pa lloz dhe gjysmë të hapur. Hyri pa e parë letrën përdhe, çau nëpër gjysmë-errësirën e sallonit, duke u munduar të mos bënte zhurmë, ngaqë qe ende shumë herët për vizita, por qentë ia nisën të lehurit nga fundi i shtëpisë dhe i prenë rrugën. I qetësoi me çelësat, siç e kishte mësuar i zoti i shtëpisë, dhe vazhdoi rrugën i ndjekur prej tyre deri në kuzhinë. Në treme u ndesh ballas me Divina Florin me kovë uji e me

shtupë për të larë dyshemenë e sallonit. Ajo e siguroi që Santiago Nasari s'qe kthyer. Viktoria Gusmani sapo kishte vënë në zjarr mishin e lepujve, kur ai hyri në kuzhinë. Ajo e kuptoi menjëherë. "S'merrte dot frymë", më tha. Kristo Bedoja e pyeti a ishte në shtëpi Santiago Nasari dhe ajo iu përgjigj me një pafajni të shtirur se ai ende s'kishte ardhur për të fjetur.

- E kam me tërë mend, - i tha Kristo Bedoja. - Po e kërkojnë për ta vrarë.

Viktoria Gusmani e harroi të shtirurit.

- S'vrasin njeri ata çunakë të gjorë, tha.

- Kanë që të shtunën që po pinë, - tha Kristo Bedoja.

- Pikërisht prandaj, - ia ktheu ajo. - S'ka pijanecë që të hanë të pëgërat e veta.

Kristo Bedoja u kthye në sallonin ku Divina Flori sapo kishte hapur dritaret. "E mbaj mend mirë që shi nuk binte, tha Kristo Bedoja. - Ora sapo kishte vajtur shtatë dhe nga dritaret hynte një diell i praruar." E pyeti edhe një herë Divina Florin nëse qe e sigurt që Santiago Nasari s'kishte hyrë nga dera e sallonit. Kësaj radhe ajo s'qe aq e sigurt sa në fillim. E pyeti për Plalasida Lineron dhe ajo iu përgjigj se para një grime i kishte shpënë kafenë te komodina pranë shtratit, por nuk e kishte zgjuar. Kështu ndodhte gjithmonë: ajo zgjohej në ora shtatë, pinte kafenë dhe zbriste për të dhënë urdhrat për gatitjen e drekës. Kristo Bedoja pa orën: ishte 6.56. Atëherë u ngjit sipër për të parë se mos Santiago Nasari kishte rënë të flinte.

Dera e dhomës së tij të gjumit ishte e mbyllur nga brenda, se Santiago Nasari kishte dalë nga dhoma e së ëmës. Kristo Bedoja jo vetëm që e njihte atë shtëpi si shtëpinë e vet, por edhe gëzonte aq besim, saqë shtyu derën e dhomës së gjumit të Plasida Lineros për të

kaluar në dhomën ngjitur. Nga baxha hynte një rreze dielli e pluhurosur. Në hamak flinte mëkrahëzaj gruaja e bukur, me dorën nën faqe si nuse e re dhe fytyra i kishte marrë një pamje vegullore. "M'u duk si një përhitje", më tha Kristo Bedoja. E kundroi për një çast, i magjepsur nga bukuria e saj, pastaj përshkoi dhomën në heshtje, kaloi pranë banjës dhe hyri në dhomën e Santiago Nasarit. Shtrati qe i paprekur, ndërsa në karrige qe vendosur me kujdes kostumi i kalërimit, mbi kostumin ishte sombreroja e kalorësit, kurse përtokë çizmet me shporret. Te komodina pranë shtratit ora e dorës e Santiago Nasarit tregonte 6.58. "Thashë një herë se mos kishte ardhur dhe kishte dalë prapë i armatosur", më tregoi Kristo Bedoja. Por "Magnumin" e gjeti në sirtarin e komodinës. "S'kisha shtënë asnjëherë me armë, - më tha ai, - por vendosa ta rnerrja revolverin me vete për t'ia dhënë Santiago Nasarit". E futi në brez, përposh këmishës dhe vetëm pas kryerjes së krimit e vuri re se ishte i pambushur. Plasida Lineroja u dha te dera me filxhanin e kafesë dorë tamam në çastin kur ai po mbyllte sirtarin.

- O zot i madh, - klithi ajo, - sa më trembe!

Edhe Kristo Bedoja u tremb. E pa në dritë të plotë, flokëshprishur e me një këmishë nate me lauresha të praruara dhe iu zhduk magjepsja. I shpjegoi pak ngatërrueshëm se kishte hyrë për të kërkuar Santiago Nasarin.

- Ka vajtur të presë ipeshkvin, - tha Plasida Lineroja.

- Ipeshkvi as që ndaloi, tha ai.

- E thashë unë, - tha ajo, - është një këlysh kurve ai!

Nuk vazhdoi, se vuri re që Kristo Bedoja rrinte si mbi gjemba. "Zoti më ndjeftë, - më tha Plasida Lineroja, - por m'u duk aq i tronditur, saqë thashë se mos kishte hyrë për të vjedhur". E pyeti ç'kishte. Kristo Bedoja e ndjeu se ishte në një pozitë të vështirë, por nuk ia mbajti të tregonte të vërtetën.

- Kam gjithë natën pa gjurnë në sy, - i tha.

Iku pa dhënë shpjegime të tjera. "Sidoqoftë, - më tha, e kuptova se ajo ishte e bindur që unë kisha vajtur për të vjedhur". Në shesh poqi at Amadorin, që po kthehej në kishë me gjithë ornamentet e meshës së dështuar, por s'i shkoi mendja se ai të mund të bënte gjë tjetër për Santiago Nasarin veçse t'i shpëtonte shpirtin. Ia mbajti edhe një herë për nga porti, kur dëgjoi ta thërrisnin prej dyqanit të Klotilde Armentës. Pudro Vikarioja rrinte te dera, irnosur dhe flokëshprishur, me këmishën të hapur dhe mëngët të përveshura deri te bërrylat, ndërsa në dorë tundte thikën primitive të bërë vetë. Qe një qëndrim mjaft provokues, pra aspak i rastësishëm, dhe ky veprim qe një ndër mjetet e shumta që përdori ai deri në çastet e fundit që t'i ndalonin të kryenin krimin.

- Kristobal, - i gërthiti, - thuaji Santiago Nasarit se po e presin këtu për ta vrarë.

Kristo Bedoja do t'u bënte nder po ta ndalonte kryerjen e këtij krimi. "Po të kisha ditur të shtija me revolver, Santiago Nasari do të ishte gjallë edhe sot e kësaj dite", më tha ai. Por edhe vetëm mendimi i të shtënit e trondití, sidomos pas gjithë sa kishte dëgjuar për fuqinë e madhe vrastare të plumbit.

- Hap sytë se është i armatosur me një "Magnum" që mund të shpojë edhe një automobil, - i bërtiti.

Pedro Vikarioja e dinte që kjo s'qe e vërtetë. "S'mbante armë me vete, po të mos kishte veshur kostumin e kalërimit", më tha. Por, sidoqoftë, e kishte marrë në sy që ai mund të ishte edhe i armatosur, kur kishte vendosur të vinte në vend nderin e motrës.

- Të vdekurve nuk u punon gishti, - thirri.

Atë çast kishte dalë te dera Pablo Vikarioja. Qe po aq i zbehtë sa i vëllai, e kishte të veshur xhaketën e dasmës dhe mbante në dorë thikën

e mbështjellë me gazetë. "Po të mos kishin qenë këto hollësi, - më tha Kristo Bedoja, - asnjëherë s‘do ta kisha marë vesh cili qe njëri e cili qe tjetri". Klotilde Armenta u dha pas Pablo Vikarios dhe i thirri Kristo Bedojës të rendte vrap, se në atë fshat shkërdhatash vetëm një burrë si ai mund ta ndalonte tragjedinë.

Gjithë ç'ndodhi paskëtaj u ndoq publikisht. Njerëzit që ktheheshin nga porti, të tërhequr prej thirrmave, filluan të zënë vendet për të bërë sehir krimin. Kristo Bedoja pyeti disa të njohur për Santiago Nasarin, por asnjeri nuk e kishte parë. Te dera e Klubit Shoqëor u ndesh me kolonel Aponten dhe i tregoi se ç'pat ndodhur pak më parë përballë dyqanit të Klotilde Armentës.

- S'ka mundësi, - i tha kolonel Aponteja. - Unë i shpura të flenë.

- Unë sapo i pashë me këta sy me thika në duar, - i tha Kristo Bedoja.

- S'ka mundësi, se unë ua hoqa para se t'i shpija të flinin, - tha alkaldi. - Do t'i kesh parë më përpara.

- S'ka as dy minuta që i pashë, secilin me nga një thikë për të therur derra, - ngulmoi Kristo Bedoja.

- Dreq o punë, - shfryu alkaldi. - Siç duket, kanë ardhur prapë me thika të tjera.

I premtoi se do të merrej vetë me këtë çështje, por hyri në klub sa të bënte një dorë domino dhe, kur doli, krimi qe kryer. Kristo Bedoja bëri atëherë të vetmin gabim dhe ky qe fatal: kujtoi se mos Santiago Nasari në çastin e fundit kishte vendosur të vinte për të ngrënë mëngjes nga ne pa u ndërruar dhe u nis ta kërkonte në shtëpinë tonë. Mori anës së lumit me ngut, duke pyetur çdokënd që takonte se mos e kishin parë të kalonte. Por askush nuk e kishte parë. Nuk u shqetësua, se kishte edhe rrugë të tjera për në shtëpinë tonë. Prospera Arangoja, fukaraçka, e kishte lutur t'i hidhte një sy të atit që po jepte shpirt në kasolle pa i pasë

bërë gjë bekimi i ipeshkvit. "Unë e kisha parë kur kalova, - më tha ime motër Margoti, - dhe kishte një çehre prej të vdekuri". Kristo Bedoja ndenji vetëm katër minuta për të parë të sëmurin dhe premtoi se do të kalonte më vonë për t'i dhënë një ndihmë urgjente, por humbi edhe tri minuta duke ndihmuar Prospera Arangon për ta shpënë të sëmurin deri në dhomën e tij. Kur doli, dëgjoi thirrje të largëta dhe iu bë sikur po hidhnin fishekzjarrë andej nga sheshi. Bëri të rendte, por e pengonte revolveri i futur keq në brez. Te kthesa e fundit njohu nga prapa time ëmë që sa s'e tërhiqte zvarrë djalin e vogël.

- Luisa Santiago, - i thirri. - Ku e ke flijonin?

Ime ëmë mezi që ktheu pakëz fytyrën e mbushur me lot.

- Ah, more bir, - iu gjegj. - Thonë se e vranë.

Dhe kështu qe. Ndërsa Kristo Bedoja e kërkonte, Santiago Nasarin, me të marrë kthesën në fund të sheshit ku ai e pa të fundit herë, kishte hyrë në shtëpinë e Flora Migelit, të fejuarës së tij. "S'më shkoi mendja se mund të kishte qenë atje, - më tha Kristo Bedoja, - se njerëzit e asaj shtëpie s'ngriheshin asnjëherë pa ardhur dreka". Bota thoshin se me urdhër të Nahir Migeiit, kryeplakut të urtë të bashkisë, e tërë familja e Migelëve flinte gjer në dymbëdhjetë të drekës. "Prandaj edhe Flora Migeli, që s'e bënte aspak qejfin qeder për punët e shtëpisë, qe e freskët si trëndafil", thoshte Mersedesi. E vërteta është se, ndonëse Migelët e mbanin derën mbyllur deri vonë, si shumë shtëpi të tjera, ata ishin njerëz puntorë që çoheshin herët. Prindërit e Santiago Nasarit e të Flora Migelit kishin rënë në ujdi që t'i martonin fëmijët. Kështu, Santiago Nasarin e fejuan qysh kur qer çunak dhe ai jo vetëm që e pranoi këtë fejesë, por qe i bindur ta shpinte deri në fund, ndoshta ngaqë kishte për martesën një ide utilitare, si dhe i ati. Flora Migeli, nga ana e saj, vërtet që kishte diçka prej luleje, por s'qe as e hirshme as e zgjuar. Në të gjitha

dasmat e brezit të saj kishte shërbyer si stolistare, kështu që fejesa me Santiago Nasarin pat qenë për të si një zgjidhje e rënë nga qielli. Kishin pasur një fejesë të lehtë, pa vizita formale dhe pa shqetësime zemre. Dasma e shtyrë disa herë, më në fund qe lënë për kërshëndellat e ardhme.

Atë mëngjes Flora Migeli u çua me t'u dëgjuar uturimat e para të anijes së ipeshkvit dhe e mori vesh pa vonesë që binjakët Vikario po e prisnin Santiago Nasarin për ta vrarë. Time motër murgeshës, të vetmes që pati rastin të fliste me të pas fatkeqësisë, i tha se as që e mbante mend prej kujt e kishte dëgjuar lajmin. "Di vetëm që në ora gjashtë të mëngjesit atë e kishte marrë vesh i madh e vogël", i tha. Megjithëkëtë, asaj iu duk e pamundur që Santiago Nasarin ta vrisnin dhe i tha mendja se do ta detyronin ta merrte për grua Anhela Vikarion për t'ia vënë nderin në vend. Pat pësuar një krizë poshtërimi. Ndërsa gjysma e fshatit priste ipeshkvin, ajo u mbyll në dhomën e vet duke dënesur nga marazi dhe duke rregulluar në kuti letrat që Santiago Nasari i kishte dërguar qysh prej kolegjit.

Sa herë që kalonte nga shtëpia e Flora Migelit, edhe sikur aty të mos kishte njeri, ai gërvishtte me çelësa kafazin e dritares. Asaj të hëne ajo po e priste me kutinë e letrave në pëqi. Santiago Nasari nuk mund ta shihte që nga rruga, ndërsa ajo e pa t'i afrohej përmes kafazit, para se ta gërvishtte me çelësa.

- Hyrë brenda, - i tha.

Kurrkush, madje as edhe mjeku, s'kishte hyrë ndonjëherë në atë shtëpi në ora 6.45 të mëngjesit. Santiago Nasari sapo qe ndarë me Kristo Bedojën te dyqani i Xhamil Shaiumit dhe në shesh kishte aq njerëz që prisnin ardhjen e tij, saqë është e pakuptueshme që askush të mos e kishte parë të hynte në shtëpinë e së fejuarës. Hetuesi kërkoi qoftë edhe një njeri që ta kishte parë dhe këtë e bëri me po aq

kërnbëngulje sa edhe unë, por nuk gjeti dot asnjë. Përanash faqes 382 të procesverbalit ai kishte shkruar me bojë të kuqe edhe një sentencë tjetër "*Fati na bën të padukshëm*" E vërteta është se Santiago Nasari hyri nga porta e rrugës, nga mund ta shihnin të gjithë, dhe pa bërë asnjë përpjekje që të mos e shihnin. Flora Migeli e priste në sallon e bërë jeshil prej zemërimit, me një nga ato fustanet me zbukurime rrathësh, që e vishte vetëm për raste, dhe i la kutinë ndër duar.

- Merri, - i tha, - dhe ishallah të vrasin!

Santiago Nasari u çudit aq shumë, saqë kutia i ra nga duart dhe letrat e tij pa dashuri u përhapën për dysheme. Bëri të arrinte Flora Migelin në dhomën e saj, por ajo e përplasi derën dhe i vuri mandallin. Ai trokiti disa herë, e thirri me një zë mjaft të lartë për atë orë të herët, saqë e gjithë familja u çua e alarmuar. Të mëdhenj e të vegjël, të një gjaku e jo të një gjaku, ata bëheshin më tepër se katërmbëdhjetë vetë. I fundit doli Nahir Migeli, babai, me mjekrën e kuqe dhe me zhyben e beduinit që e kishte sjellë prej vendlindjes dhe që e mbante gjithmonë në shtëpi. Unë e kisha parë shumë herë: qe bojalli dhe i përmbajtur, por gjëja që më bënte më shumë përshtypje ishte fuqia e autoritetit të tij.

- Flora, - thirri në gjuhën e vet. - Hape.

Hyri në dhomën e së bijës, ndërsa familja kundronte Santiago Nasarin me sy të zgurdulluar. Ai kishte rënë në gjunjë, mblidhte letrat që qenë hapërdarë për dysheme e fuste në kuti. "Dukej sikur i qe shtruar pendesës", më thanë. Nahir Migeli doli nga dhoma pas disa minutash, bëri një shenjë me dorë dhe gjithë familja u zhduk.

Vazhdoi t'i fliste arabisht Santiago Nasarit. "Qysh në çastin e parë e kuptova se ai as që e kishte haberin për ato që po i thosha", më tha. Atëherë e pyeti shkoqur, nëse e dinte apo jo që vëllezërit Vikario po e kërkonin për ta vrarë. "U verdh dhe e humbi në një mënyrë të tillë, sa

nuk mund të thoshe se shtirej", më tha. Nahir Migeli kishte arritur në përfundimin se ai qe më tepër i hutuar, sesa i frikësuar.

- Ti duhet ta dish nëse kanë të drejtë ose jo, - shtoi ai. - Por sidoqoftë, tani vetëm dy rrugë të mbeten: ose të fshihesh këtu, ku je si në shtëpinë tënde, ose të dalësh me pushkën time.

- S'marr vesh gjë prej gjëje, - tha Santiago Nasari.

Këto qenë të vetmet fjalë që mundi të thoshte dhe i tha spanjisht. "Dukej si një zogth i lagur, - më tha Nahir - M'u desh t'i hiqja kutinë e letrave nga duart se ai nuk dinte ku ta linte, për të hapur derën".

- Je një me dy, - i tha.

Santiago Nasari doli. Njerëzit kishin zënë vend në shesh si në ditët e parakalimeve. Të gjithë e panë të dilte dhe të gjithë e kuptuan se tashmë e dinte që do ta vrisnin. Dukej aq i hallakatur, sa s'gjente dot as rrugën për në shtëpi. Thonë se dikush i thirri prej një ballkoni: "Jo andej, or turk, po nga porti i vjetër!"

Santiago Nasari u përpoq të merrte vesh nga i erdhi zëri. Xhamil Shaiumi i thirri të futej në dyqanin e tij dhe hyri të kërkonte çiften, por nuk mbante mend ku i kishte fshehur fishekët. Nga të gjitha anët filluan t'i thërrisnin dhe Santiago Nasari u kthye herë djathtas e herë majtas, i hutuar krejt nga gjithë ato të thirrura njëherësh. Po shkonte për në shtëpi nga dera e kuzhinës, por siç duket i ra ndër mend se ishte hapur porta kryesore.

- Ja ku po vjen, - tha Pedro Vikarioja.

Të dy vëllezërit e kishin parë njëkohësisht. Pablo Vikarioja hoqi xhaketën, e la mbi banak dhe shpështolli thikën që dukej si jatagan. Para se të dilnin nga dyqani, pa u marrë vesh me njëri-tjetrin, bënë kryq që të dy. Atëherë Klotilde Armenta e mbërtheu Pedro Vikarion për këmishe dhe i thirri Santiago Nasarit të ikte se do ta vrisnin. Qe një thirrje aq e fortë, saqë i mbyti gjithë të tjerat. "Në fillim ai u tremb, më

tha Klotilde Armenta, - se nuk e dinte prej kujt dhe prej nga vinte thirrja". Por kur e pa atë, pa edhe Pedro Vikarion, që e flaku gruan përtokë me një të shtyrë e u bashkua me të vëllanë. Santiago Nasari ishte jo më shumë se 50 metra larg shtëpisë dhe rendi me vrap drejt portës kryesore.

Para pesë minutash, në kuzhinë, Viktoria Gusmani i kishte treguar Plasida Lineros atë që e dinin të gjithë. Plasida Lineroja qe grua me nerva të forta, kështu që e mbajti veten për mrekulli. E pyeti Viktoria Gusmamn. nëse i kishte thënë gjë të birit dhe ajo e gënjeu me ndërgjegje duke i thënë se ende s'kishte ditur gjë kur ai pat zbritur për të pirë kafenë. Në këtë kohë, Divina Florit, që po lante dyshemenë e sallonit, iu bë sikur Santiago Nasari hyri nga porta e sheshit dhe ngjiti shkallët për në dhomë të gjumit. "M'u duk sikur e pashë me këta sy, - më tregoi Divina Flori. - Qe veshur në të bardha dhe në dorë kishte diçka që s'e dallova dot mirë, por që m'u pa si një degë trëndafilash". Kështu që, kur Plasida Lineroja e pyeti për të, Divina Flori e qetësoi.

- S'ka as një minutë që u ngjit në dhomë, i tha. Plasida Lineroja pa atëherë letrën përtokë, por nuk i vajti mendja ta merrte dhe e mësoi se ç'thoshte ajo vetëm kur dikush ia tregoi më vonë, nëpër pështjellimin e tragjedisë. Nga porta gjysmë e hapur pa vëllezërit Vikario që po vinin me vrap drejt shtëpisë me thika të zhveshura. Prej vendit ku ndodhej ajo mund të shihte vetëm ata dhe nuk e shihte dot të birin që vraponte drejt portës nga këndi tjetër. "Thashë se mos donin të hynin për ta vrarë brenda në shtëpi", më tha. Dhe e mbylli portën sa hap sytë. Po i hidhte llozin, kur dëgjoi të bërtiturat e Santiago Nasarit dhe të goditurat e tmerrshme pas portës, por pandehu se i biri qe sipër dhe i shante vëllezërit Vikario nga ballkoni i dhomës së tij. U ngjit për ta ndihmuar.

Santiago Nasarit i duheshin edhe disa sekonda për të hyrë, kur porta u mbyll. Arriti të trokiste disa herë me grushte, pastaj u kthye për t'u bërë ballë armiqve me duar bosh. "U tremba kur e pashë nga përpara, - më tha Pablo Vikarioja, - se m'u duk dy herë më i madh nga ç'ishte". Santiago Nasari ngriti dorën për të pritur goditjen e parë të Pedro Vikarios, i cili ia dha në ijen e djathtë me thikën e drejtë.

- Këlyshë kurve! - ulëriu.

Thika i përshkoi pëllëmbën e djathtë, pastaj u ngul deri në fund në ijë. Të gjithë dëgjuan klithmën e dhimbjes.

- Oh, nëne!

Pedro Vikarioja e nxori thikën me një dorë të stërvitur prej kasapi dhe i dha një goditje të pothuaj në të njëjtin vend. "Qe e çuditshme se si thika dilte gjithmonë e pastër, - deklaroi Pedro Vikarioja përpara hetuesit. - E kisha goditur të paktën nja tri herë dhe s'i dilte pikë gjaku". Pas goditjes së tretë, Santiago Nasari zuri barkun me duar, rënkoi si një viç i plagosur dhe u spërdrodh duke u orvatur t'u kthente shpinën binjakëve. Pablo Vikarioja, që i rrinte në të majtë me thikën e lakuar, i dha atëherë goditjen e vetme pas shpine dhe një çurg i fuqishëm gjaku i skuqi këmishën. "Gjaku kishte erën e tij", më tha. Tri herë i plagosur për vdekje, Santiago Nasari u ktheu edhe një herë gjoksin, duke i vënë shpatullat portës të së ëmës, pa kundërshtimin më të vogël, si të deshte t'i ndihmonte që ta vrisnin në mënyrë të barabartë. "Nuk thirri më, - i tha Pedro Vikarioja hetuesit. - Përkundrazi, m'u duk sikur po qeshte". Atëherë të dy vazhduan ta bënin shoshë me thika, ashtu të mbështetur pas portës, duke e goditur radhazi, me shpejtësi dhe me lehtësi, mes një përhumbjeje sylëbyrëse në të cilën kishin rënë pasi u doli frika. As që i dëgjuan klithmat e gjindjes që po lemerisej prej krimit të tyre. "Më dukej vetja sikur po rendja me kalë", deklaroi Pablo Vikarioja. Por erdhën shpejt në vete, se u rraskapitën fare dhe u dukej

sikur Santiago Nasari nuk do të binte kurrë. “Punë muti, o kushëri, - më tha Pablo Vikarioja. S'e merr dot me mend sesa e vështirë është të vrasësh një njeri!” Duke u përpjekur t'i jepte fund, Pedro Vikarioja i kërkoi zemrën, por ia kërkoi thuajse nën sqetull, aty ku e kanë derrat. Në të vërtetë, Santiago Nasari nuk binte ngaqë e mbanin ata vetë pas portës, duke e goditur me thika. Në dëshpërim e sipër, Pablo Vikarioja i këputi një të çarë horizontale në bark dhe rropullitë i kërcyen jashtë me një zhurmë të mbytur. Të njëjtën gjë u mat të bënte edhe Pedro Vikarioja, por dora iu drodh nga tmerri dhe këputi një të prerë të shtembët në kofshë. Santiago Nasari qëndroi edhe një grimë i mbështetur pas portës, derisa ra përtokë rropullitë e tij të pastra e të kaltra, pastaj ra në gjunjë.

Si e kërkoi të birin me të thirrura nëpër të gjitha dhomat, ndërkohë që dëgjonte edhe klithma të tjera që s'qene të tijat e që s'e merrte vesh nga vini, Plasida Lineroja doli në dritaren e sheshit dhe pa binjakët Vikario tek rendnin drejt kishës. I ndiqte hap pas hapi Xhamil Shaiumi me çiften që gjuante tigra dhe arabë të tjerë të paarmatosur. Plasida Lineroja kujtoi se rreziku pat kaluar. Doli pastaj në ballkonin e dhomës së saj dhe e pa Santiago Nasarin të përmbysur para portës, në pluhur, duke u përpjekur të ngrihej mbi gjakun e vet. Ai u çua përgjysmë dhe zuri të ecte, i përkulur, mes një vegullie të plotë, duke mbajtur me duar zorrët që i vareshin përjashta.

Bëri më shumë se njëqind metra për t'i rënë qark shtëpisë dhe për të hyrë nga dera e kuzhinës. Ishte aq i vetëdijshërn sa të mos kalonte rrugës nga i binte më gjatë, por të hynte nga shtëpia ngjitur. Ponço Lanaoja, e shoqja dhe fërnijët e tij s'kishin marrë vesh se bënte vaki 20 hapa larg portës së tyre. "Dëgjuam të bërtitura, më tha e shoqja, - por thamë se qe festa e ipeshkvit". Sapo kishin mbaruar së ngrëni, kur panë

të hynte Santiago Nasari i larë në gjak, duke mbajtur ndër duar lëmshin e zorëve. Ponço Lanaoja më tha: "S'do ta harroj kurrë kutërbimin e tmerrshëm të mutit". Ndërsa Arhenida Lanaoja, vajza e tyre e madhe, tregoi se Santiago Nasari ecte me shtatin drejt, si zakonisht, duke i matur mirë hapat, dhe se fytyrës së tij prej saraçeni me kokorithkat e shpupurisura i pat rënë një nur i rallë. Kur kaloi pranë tryezës, u buzëqeshi dhe vazhdoi të çante mes për mes dhomave deri te dalja e pasme e shtëpisë. "S'lëviznim dot. Kishim ngrirë nga frika", më tha Arhenida Lanaoja. Ime emtë, Venefrida Markesi, që po pastronte peshkun në oborrin e shtëpisë së vet matanë lumit, e pa të zbriste shkallinat e magazes së vjetër, duke u drejtuar për në shtëpinë e tij.

- Santiago, o bir, - i thirri ajo. - Ç'pate?

Santiago Nasari e njohu.

- Më vranë, teto Vene, - iu përgjigj.

U pengua te shkallina e fundit, por u mbajt në çast. "Bile pati kujdes të shkundte me dorë dheun që iu ngjit pas rropullive", më tregoi ime emtë Venefrida. Pastaj hyri në shtëpi nga dera e pasme, që qe hapur qysh në gjashtë të mëngjesit, dhe u shakulleps me turinj në kuzhinë.